



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.57

2005

8 korrik

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.481, datë 30.6.2005	Për miratimin e tarifave dhe të masës së mbulimit të disa shërbimeve të trajtimit mjekësor, nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.....	2033
Vendim i KM nr.483, datë 30.6.2005	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.405, datë 8.1.1996 të Këshillit të Ministrave “Për administrimin e rrjetit rrugor kombëtar dhe rrjetit rural të Republikës së Shqipërisë“, të ndryshuar.....	2034
Vendim i KM nr.488, datë 30.6.2005	Për dhënie fondi ndihmë Partisë Shqiptare të Rindërtimit.....	2035
Vendim i KM nr.489, datë 30.6.2005	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të parcelës kullosore nr.326, nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit Ministrisë së Mbrojtjes dhe për një shtesë në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”.....	2935
Vendim i KM nr.491, datë 30.6.2005	Për disa çështje për sekuestrimin e pasurive të paluajtshme, në kuadër të masave kundër financimit të terrorizmit.....	2036
Vendim i KM nr.492, datë 30.6.2005	Për caktimin e tarifave të shërbimeve dhe mënyrën e ndarjes të së ardhurave, që realizohen në aviacionin civil.....	2037
Vendim i KM	Për disa shtesa në vendimin nr.138, datë 18.3.2005 të Këshillit të	

nr.493, datë 30.6.2005	Ministrave “Për miratimin e listës së barnave, që rimbursohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, dhe masën e mbulimit të çmimit të tyre.....	2044
Vendim i KM nr.501, datë 30.6.2005	Për kriteret e përfaqësimit, të përzgjedhjes, emërimit, shkarkimit dhe funksionimit të Këshillit të Statistikave.....	2045
Vendim i KM nr.502, datë 30.6.2005	Për ekzekutimin e vendimit të datës 18.11.2004 të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, për çështjen “Qufaj CO, sh.p.k. kundër Shqipërisë”.....	2046
Vendim i KM nr.503, datë 30.6.2005	Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.....	2047
Vendim i KM nr.505, datë 30.6.2005	Për një shtesë në vendimin nr.343, datë 11.7.2002 të Këshillit të Ministrave “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë”, të ndryshuar.....	2048
Vendim i KM nr.509, datë 30.6.2005	Për një ndryshim në vendimin nr.56, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve të Shërbimit Informativ Kombëtar”, të ndryshuar....	2049
Udhëzim i MRRTT nr.3, datë 28.6.2005	Për përcaktimin e kushteve teknike të ndërtimit dhe përdorimit të varrezave mbitokësore.....	2050
Udhëzim MRRTT nr.4, datë 7.7.2005	Për procedurat e blerjes së banesave në treg nga Enti Kombëtar i Banesave.....	2051
Vendim i GJK nr.5, datë 8.3.2005	Me objekt shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i togfjalëshit “... më shumë se një herë”, parashikuar në nenin 278, paragrafi i katërt i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë..	2052
Vendim i GJK nr.14, datë 5.7.2005	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.1865, datë 15.10.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetues.....	2055
Vendim i GJL nr.1, datë 25.3.2005	Me objekt kryerjen e veprave penale të rrëmbimit të personit, në bashkëpunim, dhe mbajtje e armëve pa leje, parashikuar nga nenet 109, paragrafi i parë, 25 dhe 279, paragrafi i dytë të Kodit Penal.....	2059
Vendim i KKRT nr.349, datë 10.6.2005	Për dhënie licence për televizionin vendor privat “TV Berati”...	2068
Vendim i KKRT nr.350, datë 10.6.2005	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik “BOOM-BOOM”	2068
Vendim i KKRT nr.352, datë 10.6.2005	Mbi zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit televiziv vendor privat “News 24”.....	2069
	Shpallje kërkesë për shpronësim, me objekt shpronësimin për interes publik të objektit “Rikonstruksionin e lagjes “Granicë” në qytetin e Gjirokastrës”.....	2069
	Vendim i shkurtuar për caktimin e shtetases Pranvera Zaçe si kujdestare të fëmijëve të mitur Sherif Zaçe dhe Marius Zaçe.....	2069

VENDIM
Nr.481, datë 30.6.2005

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE DHE TË MASËS SË MBULIMIT TË DISA SHËRBIMEVE
TË TRAJTIMIT MJEKËSOR, NGA INSTITUTI I SIGURIMEVE TË KUJDESIT
SHËNDETËSOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, pika 2, shkronja “c”, e 14, paragrafi i fundit të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrisë të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e disa shërbimeve të trajtimit mjekësor, që do të mbulohen nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, për spitalin e Durrësit, sipas pasqyrës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Masa e mbulimit të shpenzimeve për shërbimet e trajtimit mjekësor, sipas pikës 1 të këtij vendimi, nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, për personat e siguruar të jetë 100 për qind.
 3. Pacientët e pasiguruar mund t’i përfitojnë shërbimet e trajtimit sipas pasqyrës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, kundrejt pagesës së tarifës së plotë për shërbimin.
 4. Efekti financiar vjetor prej 85 000 000 (tetëdhjetë e pesë milionë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve për këto shërbime nga skema e sigurimeve shëndetësore, për vitin 2005, të përballohet nga fondi i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.
 5. Ngarkohen Ministri i Shëndetësisë dhe drejtori i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor të përcaktojnë procedurat dhe të nxjerrin udhëzimet përkatëse në zbatim të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Pasqyra 1

**LISTA E TRAJTIMEVE TË CILAT MBULOHEN NGA INSTITUTI I SIGURIMEVE
SHËNDETËSORE DHE TARIFA**

Trajtimi	Tarifa
1. Hemodializa	11 000 lekë për seancë
2. Koronarografia me stent	350 000 lekë për rast
3. Kirurgjia ortopedike (proteza)	312 000 lekë për rast

VENDIM
Nr.483, datë 30.6.2005

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.405, DATË 8.1.1996 TË

**KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR ADMINISTRIMIN E RRJETIT RRUGOR
KOMBËTAR DHE RRJETIT RURAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË“, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.405, datë 8.1.1996 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 1, rrjetit rrugor kombëtar t’i shtohen dhe “107 km” rrugë.

b) Në lidhjen 1 “Rrjeti rrugor kombëtar”, që i bashkëlidhet vendimit, shtohen emërtimet si më poshtë vijon:

“- Drejtorisë Rajonale të Mirëmbajtjes së Rrugëve, Lushnjë

Kthesa Fier-Shegan-Allkaj-Krutje-Pushim i Shoferit-Gradishtë-Divjakë, 12 km rrugë interurbane, dytësore.

- Drejtorisë Rajonale të Mirëmbajtjes së Rrugëve, Elbasan

Belsh-Kufi Kuçovë, 15 km rrugë interurbane, dytësore.

- Drejtorisë Rajonale të Mirëmbajtjes së Rrugëve, Berat

Kufi Kuçovë-Kuçovë, 10 km rrugë interurbane, dytësore.

- Drejtorisë Rajonale të Mirëmbajtjes së Rrugëve, Fushë-Arrëz

Fushë-Arrëz-Iballë, 60 km rrugë interurbane, dytësore.

- Drejtorisë Rajonale të Mirëmbajtjes së Rrugëve, Korçë

Bilisht-Hoçisht, 6 km rrugë interurbane, dytësore.

Ura Hoçisht- Baban, 4 km rrugë interurbane, dytësore.”.

c) Në tabelën “Inventari i rrugëve rurale, rajonale e komunale”, që i bashkëlidhet vendimit, hiqen emërtimet si më poshtë vijon:

“- Kthesa Fier-Shegan-Allkaj-Krutje-Pushim i Shoferit-Gradishtë-Divjakë.

- Belsh-Kufi Kuçovë.

- Kufi Kuçovë-Kuçovë.

- Fushë-Arrëz-Iballë.

- Bilisht-Hoçisht.

- Ura-Hoçisht-Baban.”.

2. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit dhe Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

**VENDIM
Nr.488, datë 30.6.2005**

PËR DHËNIE FONDI NDIHMË PARTISË SHQIPTARE TË RINDËRTIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 “Për

partitë politike”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 10 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Partisë Shqiptare të Rindërtimit t’i jepet një fond prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh, si ndihmë financiare.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 3. Ngarkohet Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.489, datë 30.6.2005

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË PARCELËS KULLOSORE NR.326, NGA MINISTRIA E BUJQËSISË DHE E USHQIMIT MINISTRISË SË MBROJTJES DHE PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËTËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe të nenit 7 të ligjit nr.7623, datë 13.10.1992 “Për pyjet dhe Policinë e Shërbimit Pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Parcelës kullosore nr.326, në zonën veriore të pronës nr.133, në Yzberisht, Tiranë, me sipërfaqe 4.2 ha, t’i ndryshojë përgjegjësia e administrimit nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit të Ministria e Mbrojtjes, për ngritjen e kazermës së repartit ushtarak nr.1109 “Shkolla e trupës së Forcave Tokësore”.
 2. Parcela kullosore, e përcaktuar në pikën 1, të përfshihet në pronën nr.133, me emërtimin “Reparti ushtarak nr.1400 AKA, Yzberisht, Tiranë”, në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shetëtorë, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.
 3. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIMI
Nr.491, datë 30.6.2005

PËR DISA ÇËSHTJE PËR SEKUESTRIMIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME, NË KUADËR TË MASAVE KUNDËR FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18 të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Të rregullojë çështjet që lindin në çastin e sekuestrimit të pasurive të paluajtshme, mënyrën e administrimit të tyre deri në dorëzimin e pasurive të paluajtshme subjektit përkatës, sipas ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”. Pasuritë e paluajtshme, të sekuestruara kanë për pronar personin e shpallur si financues të terrorizmit, ndërsa Ministri i Financave, me anë të administratorëve të caktuar, kryen vetëm administrimin e tyre.

2. Me vendosjen e sekuestros mbi fondet dhe pasuritë, në kuadër të masave kundër financimit të terrorizmit, Ministri i Financave cakton një administrator për administrimin e këtyre fondeve dhe pasurive të sekuestruara.

3. Administratorët caktohen nga radhët e nëpunësve civilë të Ministrisë së Financave, me të cilët lidhet një kontratë pune, me kohë të pjesshme. Në kontratën e punës parashikohet, shprehimisht, objekti i ngarkuar për administrim, kompetencat dhe përgjegjësitë e administratorit, si dhe zgjidhja e njëanshme e kontratës nga ministri në rast keqadministrimi dhe shpërdorimi të objektit të sekuestruar. Masa e shpërblimit mujor është 30 000 (tridhjetë mijë) lekë. Pjesë përbërëse të kontratës janë inventari i objektit të sekuestruar dhe procesverbali i marrjes në dorëzim të tij.

4. Administratori kryen inventarin e pasurisë së paluajtshme në prani të përfaqësuesve të Ministrisë së Financave, si dhe merr masa për administrimin e pasurisë, ushtron të drejtën e padisë e u përgjigjet padive për këtë pasuri, depoziton paratë, që rrjedhin eventualisht nga kjo pasuri, kryen veprime të tjera të kësaj natyre dhe jep llogari me mbarimin e administrimit.

KREU II PASURITË E PALUAJTSHME

1. Pasuritë e paluajtshme, të sekuestruara, me urdhër të Ministrit të Financave, në bazë të kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, u jepen në përdorim, për sistemim me zyra (nëse janë të përshtatshme), institucioneve shtetërore, buxhetore.

Pasuritë e paluajtshme, si truall, tokë bujqësore, u nënshtrohen planeve rregulluese urbanistike dhe të ardhurat e krijuara derdhen në llogaritë e çelura për këtë qëllim në Bankën e Shqipërisë.

2. Institucionet shtetërore, buxhetore, të cilave u jepen në përdorim pasuritë e paluajtshme, nënshkruajnë një kontratë huapërdorjeje me administratorin e caktuar për administrimin e kësaj pasurie.

3. Shpenzimet për sigurimin e pasurisë së paluajtshme, të dhënë në huapërdorje, si dhe çdo shpenzim tjetër, për përdorimin e tyre, përballohen nga institucioni shtetëror, buxhetor, që e ka në përdorim.

4. Për pasuritë e paluajtshme në bashkëpronësi, administrimi i të cilave është i pamundur për shkaqe objektive, administratori ka të drejtë të kërkojë pjesëtimin e sendit në natyrë.

5. Pasuritë e paluajtshme (objekte) jepen në përdorim pasi të jetë marrë leja e shfrytëzimit, në zbatim të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.

KREU III SHPENZIMET E ADMINISTRIMIT DHE DISPOZITA TË FUNDIT

1. Shpenzimet e administrimit, si shpërblimi i administratorit, pagesa e taksave eventuale apo çdo shpenzim tjetër i parashikuar, janë në ngarkim të Ministrisë së Financave. Për çdo shpenzim të kryer administratori paraqet faturën apo dokumentin përkatës, si dhe një relacion për domosdoshmërinë e kryerjes së këtij shpenzimi.

2. Në përfundim të sekuestros, në njërën nga mënyrat e parashikuara në ligjin nr.9258, datë

15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, administratori ndërmerr hapa të menjëhershme për dorëzimin e pasurisë së paluajtshme te Ministri i Financave, kundrejt një procesverballi dorëzimi dhe një inventari përkatës.

3. Ngarkohen Ministri i Financave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.492, datë 30.6.2005

**PËR CAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE DHE MËNYRËN E NDARJES TË SË
ARDHURAVE, QË REALIZOHEN NË AVIACIONIN CIVIL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.7877, datë 30.11.1994 “Për aviacionin civil shqiptar”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tarifat për shërbimet, që zbatohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil, të jenë sipas lidhjeve 1, 2, 3, 4, 5, 6 që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Të ardhurat, që realizohen nga shërbimet, të administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil, në masën dhe sipas kriterëve të përcaktuara në vendimin nr.424, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”, dhe në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit “Mbi krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore të sistemit të transportit dhe të telekomunikacionit”, përkatësisht nr.674, datë 8.10.2003 dhe nr.4381, datë 17.9.2003.

3. Vendimi nr.231, datë 25.4.1995 i Këshillit të Ministrave “Për caktimin e tarifave të shërbimeve e mënyra e ndarjes të së ardhurave, që realizohen në aviacionin civil”, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LIDHJA NR. 1 TARIFAT E PAGESAVE PER AUTORIZIMET

NR	EMERTIMI	AFATI	000/leke		SHENIME	ISHITES
			VLERA			YKM 231
1	Autorizim per Operime Ajrore Nderkombetare te rregullta	1 vit	200,000			50,000
		5 vjet	1,000,000			320,000
2	Autorizim per Operime Ajrore Nderkombetare jo te rregullta	1 vit	50,000			30,000
		5 vjet	250,000			120,000
3	Autorizim per Operime Ajrore te Brendshme te rregullta	1 vit	30,000			20,000
		5 vjet	1,000,000			80,000
4	Autorizim per Operime Ajrore te Brendshme jo te rregullta	1 vit	20,000			12,500
		5 vjet	100,000			50,000
5	Autorizim per Aviacionin e Pergjithshem	1 vit	50,000			1,000
		5 vjet	250,000			4,000

LIDHJA NR. 2 TARIKAT E PAGESAVE PER CERTIFIKATAT E OPERATOREVE AJRORE

NR.	EMERTIMI	AFATI	(000/leke)		SHENIME	ISHTE VKM 231
			VLERA			
1	Certifikate e Operimit Ajror (COA) Nderkombetar te rregullta	6 muaj 1 vit	100,000 500,000			50,000 200,000
2	COA nderkombetar jo te rregullta	6 muaj 1 vit	50,000 100,000			25,000 100,000
3	COA te brendshme te rregullta	6 muaj 1 vit	25,000 50,000			15,000 30,000
4	COA te brendshme jo te rregullta	6 muaj 1 vit	10,000 25,000			7,500 15,000
5	Certifikate per Operime te Aviacionit te Pergjithshem	6 muaj 1 vit	10,000 25,000			500 1,000
6	Leje operimi per fluturime turistike charter		10€/pasagjer		aplikohet per cdo fluturim	nuk ekzistonite
7	Perseritja e Autorizimeve & Certifikatave Sipas Lidhjeve Nr. 1 & Nr. 2				Aplikohet po ajo tarife, ajo e tarifes me te madhe	ishite 50% e tarifave

LIDHJA NR. 3 TARI FAT E PAGESAVE PER DOKUMENTAT E AVIONIT

000/leke

NR.	EMERTIMI	AFATI	VLERA	SHENIME	ISHTE
1	Certifikate e Rregjistrimit te avionit: Avione me peshe deri ne 3,000 kg Avione me peshe mbi 3,000 kg	Pa afat	5,000 me formule 5,000 + (1,000 L per cdo 1,000kg)		pa formule pa afat 2,000
2	Leja per te kryer fluturimet "ferry"		25,000		nuk ekziston
3	Certifikata e vlefshmerise Ajrore : Avione me peshe nen 5,700 kg Avione me peshe mbi 5,700 kg	1 vit	20,000 me formule 20,000+(100,000L per cdo 1,000kg)		deri ne 1 vit 2,000
4	Perseritja e certifikates se vlefshmerise		20,000	Paguhet tarifa me e vogel	50% e tarifes
5	Certifikata e vlefshmerise per Gliderin	1 vit	10,000		nuk ekziston
6	Certifikata e zhurmave	pa afat	20,000		5 vjet/1,000 L
7	Manuali i Operimeve	pa afat	25,000	Per cdo amendim 10% e shumes se tarifes	10,000 pa amendime 10,000
8	Manuali i fluturimit	pa afat	25,000	Per cdo amendim 10% e shumes se tarifes	
9	Manuali i mirembajtjes	pa afat	25,000	Per cdo amendim 10% e shumes se tarifes	10,000

LIDHJA NR 4. APROVIMET NGA DPAC

000/leke

NR	EMERTIMI	AFATI	VLERA	SHENIME	Ishtë
1	Aprovimi I Qendrave te Mirembajtjes	Vit	100,000		nuk ekziston
2	Kryerja e nje testi fluturimi		15,000		nuk ekziston
3	Aprovimi I Qendrave te trainimit	vit	100,000		nuk ekziston
4	Aprovimi I Qendrave te trainimit/ANTA	vit	100,000		nuk ekziston
5	Aprovimi I personit te Autorizuar per trainim	pa afat	50,000		nuk ekziston
6	Aprovimi per instruktores ne ANTA	pa afat	50,000		nuk ekziston
7	Aprovimi I modifikimeve		100,000	per avionet shtetore aplikohet 50% e tarifave te mesiperme	nuk ekziston nuk ekziston

LIDHJA NR 5. LICENSAT E PERSONELIT FLUTURUES DHE TEKNIK

		(000/leke)					
NR	EMERTIMI	AFATI	VLERA	SHENIME	ISHTE		
1	Licensa e inxhinierit te avionit Tip I&II	5 vjet	25,000			2vj/700L	
2	Licensa e mekanikut te avionit Tip I&II	2 vjet	25,000			2vj/700L	
3	Licensa e pilotit te Linjave Ajrore	2 vjet vlere kartoni	25,000	per vazhdimesine e licenses per cdo 6 muaj shtohet +10,000L.Ne rastet kur vlefshmeria jepet nje here/vit kemi 25,000+20,000 L per te gjitha mjetet fluturuese.		1v/2000L	
4	Licensa e pilotave komerciale	5Vjet/V. kartoni	25,000	Apikohet njesoj si Licensa e Pilotit te linjave ajrore		1v/1500L	
5	License Piloti Privat	5Vjet/V. kartoni	5,000	Kesaj vlere l shtohet +5,000L vlefshmeria per vit & +10,000L/cdo dy vjet		1v/750L	
6	Leje e pilotit student	5 vjet	5,000			nuk ekzis	
7	Licensa e Navigatorit	5Vjet/V. kartoni	25,000	Kesaj vlere l shtohet +10,000L vlefshmeria/vit		1v/1000L	
8	Licensa e Inxhinierit te fluturimit	5Vjet/V. kartoni	25,000	Kesaj tarife l shtohet +10,000L ne vit		1v/1000L	
9	License per stafin inxhinieroteknik/ANTA	pa afat	6,000			nuk ekzis	
10	Licensa e Dispecerit	5Vjet/V. kartoni	15,000	Kesaj tarife l shtohet +5,000L ne vit		400	
11	Licensa e Stuardesave	5Vjet/V. kartoni	10,000	Kesaj tarife l shtohet +5,000L ne vit		400	
12	License per kontrollor trafiku	pa afat	7,000			500	
13	License per shoqeruese gabine	pa afat	8,000			400	

LIDHJA NR. 6 LICENSAT E OPERATOREVE AEROPORTUALE
& LICENSA PER AGJENSITE E SHITJES SE BILETAVE AJRORE

NR	EMERTIMI	AFATI	VLERA	SHENIME	ISHTE
1	Licensa e Operatorit te Aeroportit ose Certifikata e Operimit	1 vit	50,000 €	Vlera ne EURO	nuk ekziston
2	Licensa e Operimit te ANTA-s	1 vit	150,000 €		nuk ekziston
3	Miratimi i Manualit Operacional te Aerop.		1,000,000	shprehur ne leke Per cdo amendim 10% e tarifes	nuk ekziston
4	Licensa e Sherbimeve te Sigurise			Mbulohet nga tarifa e sigurise	nuk ekziston
5	Leja per vetsherbimet e karburantit	1 vit 5 vjet	100,000 500,000	shprehur ne leke "	5vj/30,000L
6	Leja per vetsherbimet kargo	1 vit 5 vjet	50,000 250,000	shprehur ne leke "	5vj/30,000L
7	Leja per sherbimet e kateringut	1 vit 5 vjet	20,000 100,000	shprehur ne leke "	5vj/30,000L
8	Licensa e radio operatorit	1 vit 5 vjet	100,000 500,000	shprehur ne leke "	nuk ekziston
9	Licence per Agjensite e shitjes se biletave ajrore	6/muaj	30,000	leke. Rinovimi jepet per periudhe 1 vit me te njejten vlere	30,000L fillest 15,000L rinovim

VENDIM
Nr.493, datë 30.6.2005

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.138, DATË 18.3.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “ PËR MIRATIMIN E LISTËS SË BARNAVE, QË RIMBURSOHEN NGA
INSTITUTI I SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR, DHE MASËN E MBULIMIT
TË ÇMIMIT TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 e 15 të ligjit nr.7870, datë 13.4.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.138, datë 18.3.2005 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa:

1. Në listën “Lista e barnave të rimbursuara 2005”, shtohen barnat, sipas pasqyrës I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Në pasqyrën III “Lista e barnave me marzhet e diferencuara në listën 2005”, shtohen të dhënat sipas pasqyrës II, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Pasqyra I

KodBari	KodiATC	EmertimiKimik	Forma	EmriTregtar	Firma	Cmimi Reference	Cmimi Pacientit	Rimb.
PSIKOLEPTIKET								
276/99	N05AX08	Risperidon 2mg.	tabl.	Risset	PLIVA	84	16.80	67.20
276/79	N05AX08	Risperidon 2mg.	tabl.	Rispolux	LEK	84	16.80	67.20
276/6	N05AX08	Risperidon 2mg.	tabl.	Risperidon	ALKALOID AD	132	64.80	67.20
276/79	N05AX08	Risperidon 2mg.	tabl.	Rispolept	JANSSEN-CILAG	218	150.80	67.20

Pasqyra II

Marzhi i grosistit 15%, marzhi i farmacise 30%

Kodi barit	Kodi ATC	Emri kimik	Forma
276	N05AX08	Risperidonum 2mg	tabl.

VENDIM
Nr.501, datë 30.6.2005

PËR KRITERET E PËRFAQËSIMIT, TË PËRZGJEDHJES, EMËRIMIT, SHKARKIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT TË STATISTIKAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9180, datë 5.2.2004 “Për statistikën zyrtare”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Kriteret e përfaqësimit, të përzgjedhjes, emërimit, shkarkimit dhe funksionimit të Këshillit të Statistikave, i cili përbëhet nga 11 anëtarë, të jenë:

1. Përbërja e Këshillit të Statistikave

Anëtarët e Këshillit të Statistikave, të cilët emërohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e zëvendëskryeministrit, përfaqësojnë institucionet kryesore dhe grupet e përfshira në nxjerrjen e statistikave zyrtare si më poshtë vijon:

- | | |
|--|------------|
| - Agjencitë statistikore | 5 anëtarë; |
| - Qarqet akademike dhe shkencore | 3 anëtarë; |
| - Komuniteti i biznesit, shoqërisë civile dhe medias | 3 anëtarë. |

2. Kriteret e përzgjedhjes

a) Anëtarët duhet të jenë persona të kualifikuar nga fusha ekonomike e sociale, që kanë reputacion të spikatur, të jenë me aftësi dhe përvojë në fushën e statistikës, në atë ekonomike, sociale e mjedisore.

b) Anëtarët, në veprimtarinë e tyre, duhet të jenë të paanshëm dhe transparentë, të pavaruar politikisht, për zgjedhjen e teknikave sa më të përshtatshme në nxjerrjen e statistikave zyrtare.

3. Kohëzgjatja e qëndrimit në detyrë e anëtarit

a) Anëtari i Këshillit të Statistikave emërohet për një periudhë shtatëvjeçare, me të drejtë riemërimi vetëm një herë.

b) Mandati i anëtarit mbaron kur:

- dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- nuk paraqitet në detyrë pa arsye më shumë se në tri mbledhje;
- jep dorëheqjen;
- deklarohet i paafte për të vepruar, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

4. Zëvendësimi i anëtarit

Për rastet e mbarimit të mandatit, parashikuar në shkronjën “b” të pikës 3, zëvendësimi i anëtarit bëhet sipas procedurave të sipërpërmendura. Këshilli i Ministrave, me vendim, emëron anëtarin e ri, në bazë të propozimit të dhënë nga Këshilli i Statistikave.

5. Organet drejtuese

a) Organet drejtuese të Këshillit të Statistikave janë:

- kryetari;
- zëvendëskryetari.

b) Kryetari dhe zëvendëskryetari zgjidhen nga anëtarët e Këshillit të Statistikave, me 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve.

Kryetari përfaqëson Këshillin e Statistikave në marrëdhënie me të tretët për vendimet që merr këshilli.

6. Mbledhja e Këshillit të Statistikave

a) Këshilli i Statistikave mbledhet në seancë të zakonshme të paktën një herë në vit, me kërkesë të kryetarit dhe në të duhet të marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve. Këshilli mund të mbledhet në seancë të jashtëzakonshme kur e kërkon kryetari i këshillit ose të paktën 1/3 e anëtarëve të tij.

b) Anëtarët njoftohen me shkrim për datën, orën dhe vendin ku do të zhvillohet mbledhja, si dhe për rendin e ditës, që do të shqyrtohet në mbledhje. Si rregull, njoftimi bëhet të paktën 10 ditë përpara datës së mbledhjes. Për çështje urgjente kryetari i këshillit mund të thërrasë mbledhjen, duke mosrespektuar afatet e mësipërme, por, detyrimisht, me një njoftim me shkrim.

c) Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it merr pjesë në mbledhje, pa të drejtë vote.

7. Vendimet

Mbledhjet zhvillohen kur janë të pranishëm më shumë se 2/3 e anëtarëve të Këshillit të Statistikave. Vendimet e Këshillit të Statistikave merren me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm. Në rast të votave të barabarta, vota e kryetarit është vendimtare.

8. Sekretariati

a) Shërbimi i sekretariatit sigurohet nga INSTAT-i.

b) Sekretariati i Këshillit përbëhet nga dy anëtarë, njëri nga INSTAT-i dhe tjetri nga Këshilli i Statistikave.

c) Detyrat e sekretariatit vendosen nga Këshilli i Statistikave, me vendim të veçantë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.502, datë 30.6.2005

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË DATËS 18.11.2004 TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, PËR ÇËSHTJEN “QUFAJ CO, SHPK KUNDËR SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit 1 të nenit 46 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e konventës europiane për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore” dhe të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit nr.54268/00 të datës 18.11.2004 të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, për çështjen, “Qufaj Co, sh.p.k., kundër Shqipërisë”, brenda datës 30 qershor 2005, në shumat 60 000 000 (gjashtëdhjetë milionë) lekë dhe 72 000 (shtatëdhjetë e dy mijë) euro, nga Ministria e Financave.

2. Detyrimi financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet në shumën 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, dhe pjesa tjetër nga fondet e planifikuara për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, miratuar në buxhetin e vitit 2005, për Ministrinë e Financave.

3. Shuma e përcaktuar si detyrim të depozitohet në njërin nga bankat e nivelit të dytë, në emër të shoqërisë “Qufaj Co, sh.p.k.”, regjistruar në Gjykatën e Rrethit, Tiranë, me vendimin nr.5883, datë 20.7.1992.

Shuma prej 72 000 (shtatëdhjetë e dy mijë) eurosh të konvertohet në lekë me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën kur do të çelet llogaria.

4. Pagimi i shumës së depozituar sipas pikës 3 të këtij vendimi, ndaj shoqërisë “Qufaj Co, sh.p.k.”, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.

5. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.503, datë 30.6.2005

PËR ORGANIZIMIN, KOMPETENCAT DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 36 të ligjit nr.9284, datë

30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për Buxhetin e Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 10 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, më poshtë Agjencia, është institucion buxhetor, në varësi të Ministrit të Financave.

2. Agjencia merr masat e nevojshme për administrimin e fondeve dhe të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, të personave të dyshuar apo të shpallur si pjesëmarrës në krimin e organizuar, sipas vendimeve gjyqësore, të formës së prerë.

3. Agjencia ka këtë objekt të veprimtarisë:

a) Bashkëpunon me institucionet pjesëmarrëse në procesin e administrimit dhe të konfiskimit të pasurive, si me gjykatat, prokurorinë, njësitë e qeverisjes vendore dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ku ndodhen pasuritë e paluajtshme, të konfiskuara.

b) Përgatit raportin e vlerësimit tekniko-financiar, të cilin ia paraqet për miratim e vendimmarrje Ministrit të Financave, në përputhje me pikat 2 e 3 të nenit 31 të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004.

c) Autorizon administratorin e caktuar në vendimin për sekuestrimin e pasurisë, që, në raste të veçanta, të kërkojë ndihmën e specialistëve apo të personave të tjerë.

4. Agjencia përbëhet nga 3 (tre) administratorë, njëri nga të cilët është kryeadministrator, dhe 1 (një) specialist i rrjetit kompjuterik për ngritjen, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara.

Marrëdhëniet e punës së punonjësve të Agjencisë rregullohen me ligjin nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

5. Kryeadministratori emërohet nga Ministri i Financave dhe ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) Drejton dhe administron veprimtarinë e Agjencisë dhe përgjigjet para Ministrit të Financave për veprimet e ndërmarra gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie.

b) Harton rregulloren e brendshme të Agjencisë, të cilën ia paraqet për miratim Ministrit të Financave.

c) Përgjigjet para Ministrit të Financave për procesin e sekuestrimit dhe të konfiskimit të pasurive.

ç) Përfaqëson Agjencinë në marrëdhënie me të tretët, në përputhje me rregulloren e brendshme.

d) Pas verifikimit të kërkesave të paraqitura nga institucionet e parashikuara për financimin e projekteve për administrimin e pasurive të paluajtshme të konfiskuara, si dhe të atyre të përcaktuara në pikat 2 shkronjat “a”, “b”, “c” e “ç”, e 3 të nenit 39 të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, përgatit dokumentacionin përkatës, të cilin ia dërgon për mendim Komitetit Këshillues të Masave kundër Krimit të Organizuar dhe ndjek zbatimin e këtyre projekteve.

6. Administratorët e ushtrojnë veprimtarinë në çastin e caktimit, me vendim gjykatë të formës së prerë, të sekuestros mbi pasurinë, me propozimin e Agjencisë, në përputhje me nenin 19 të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004.

7. Të drejtat dhe detyrat e administratorit të Agjencisë janë:

a) Të urdhërojë pronarin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar të paraqesë:

i) një raport për pasurinë, me qëllim evidentimin e përdorimit të saj;

ii) librat e llogarisë për pasurinë e sekuestruar apo të konfiskuar.

b) Të dërgojë raportin periodik para gjykatës, për administrimin e pasurisë së sekuestruar, ku përfshihet edhe përshkrimi i ndalimeve, të përcaktuara në nenin 21 të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004.

c) Të dërgojë te prokurori, në raste të veçanta, raportin e administrimit të pasurisë së sekuestruar.

Kur e çmon të nevojshme, për përmbushjen e detyrave, kërkon ndihmën e ekspertëve, sipas fushave të caktuara, të cilët shpërblehen për punën e bërë sipas akteve ligjore e nënligjore, në fuqi.

8. Përdorimi dhe shitja e pasurive të paluajtshme, e mjeteve monetare dhe e pasurive të luajtshme bëhet në përputhje me nenet 33, 34 e 35 të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”.

9. Ministrisë së Financave, në buxhetin e miratuar për vitin 2005, t’i shtohet fondi prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh, për përballimin e efekteve financiare për ngritjen dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

10. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

11. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.505, datë 30.6.2005

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.343, DATË 11.7.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAJISJEN ME NUMËR TELEFONI CELULAR TË PERSONAVE
JURIDIKË, PUBLIKË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 2 të vendimit nr.343, datë 11.7.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Për përballimin e ngarkesës gjatë fushatës së zgjedhjeve parlamentare të vitit 2005, deri më datë 17.7.2005 për të gjitha funksionet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, që e përfitojnë këtë shërbim, përballimi i shpenzimeve nga buxheti i institucionit të jetë deri në shumën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë në muaj.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.509, datë 30.6.2005

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.56, DATË 27.2.1992 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHITESA MBI PAGË TË
USHTARAKËVE TË SHËRBIMIT INFORMATIV KOMBËTAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave “ç” e “dh” të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.56, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, lidhja nr.1 “Paga bazë sipas klasave për punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi i pashpërndarë i pagave, në bazë të përcaktimit të bërë në nenit 8 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2005”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 gusht 2005.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Lidhja nr.1

PAGA BAZË SIPAS KLASAVE PËR PUNONJËSIT E SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHETIT

Nr.rendor	Klasa	Paga bazë mujore në lekë
1	I	11 800
2	II	12 000
3	III	12 250
4	IV	12 500
5	V	12 700
6	VI	12 900
7	VII	13 200
8	VIII	13 400
9	IX	13 800
10	X	14 200
11	XI	14 800
12	XII	15 300
13	XII	15 900
14	XIV	17 000
15	XV	19 000
16	XVI	20 000
17	XVII	21 500
18	XVIII	24 000
19	XIX	27 000
20	XX	30 000
21	XXI	33 500
22	XXII	38 500

UDHËZIM
Nr.3, datë 28.6.2005

**PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE TEKNIKE TË NDËRTIMIT DHE PËRDORIMIT TË
VARREZAVE MBITOKËSORE**

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 16 pika 4 të ligjit nr.9220, datë 15.4.2004 “Për shërbimin publik të varrimit”, Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit

UDHËZON:

1. Varrimi mbitokësor konsiston në vendosjen e kufomave ose eshtrave në godina të ndërtuara mbi sipërfaqen e tokës.

2. Varrezat mbitokësore janë dy llojesh: varreza mbitokësore të kufomave njerëzore dhe varreza mbitokësore të eshtrave njerëzore.

3. Varrezat mbitokësore ndërtohen me dhomëza të mbivendosura në shumë kate. Ato duhet të

jenë të ajrosura dhe të ndriçuara mirë. Në çdo pjesë të katit duhet të ketë një vend të lirë ku do të manovrohet për të futur arkivolin ose kasën e eshtrave.

4. Në varrimet mbitokësore me shumë kate, çdo arkivol ose kasë eshtrash duhet të vendoset në dhomëz të ndarë më vete.

5. Struktura e dhomëzave të varrimeve mbitokësore, qofshin këto të ndërtuara në vend apo prej parafabrikatesh, duhet t'u korrespondojnë kërkesave të qëndrueshmërisë së strukturave në ndërtim.

6. Soletat horizontale të dhomëzave, duhet të llogariten që të përballojnë një mbipeshë të paktën prej 250 kg për metër katror.

7. Faqet e dhomëzave, ato vertikale dhe horizontale, duhet të kenë karakteristikën e papërshkueshmërisë ndaj lëngjeve dhe gazeve dhe të jenë në gjendje që t'i rezistojnë kohës së gjatë të përdorimit.

8. Është e preferueshme që konstruksionet e varreve mbitokësore të jenë të veshura me granit ose mermer. Dhomëzat e kufomave të kenë formën e një paralelopipedi me gjatësi 2 m, gjerësi 0,80 m dhe lartësi 0,70 m. Këto dimensione lejojnë një hapësirë të brendshme të varrit për të futur lirshëm arkivolin në të.

9. Dhomëzat vendosen në rreshta, njëra mbi tjetrën, duke realizuar një ndërtim në lartësi. Këshillohet që numuri i rreshtave të mos jetë më shumë se katër. Në raste të ndërtimit më të lartë, në çdo katër rreshta duhet të ketë një vend të posaçëm, me shkallë ose ashensor, për të manovruar për vendosjen e arkivolit të kufomës në katet e sipërme.

10. Muret anësore mbajtëse të godinës së varrezave mbitokësore duhet të jenë të paktën me trashësi 40 cm. Soletat ndarëse të dhomëzave zakonisht kanë një trashësi jo më të vogël se 10 cm, dhe kur ndërtohen me parafabrike jo më të vogël se 5 cm.

11. Mbyllja e dhomëzave mund të bëhet me mur tulle, me gurë natyralë, me parafabrike ose materiale të tjera që të realizojnë një mbyllje hermetike, me trashësi 15 cm. Mbas mbylljes, faqja ballore e saj zbukurohet, sipas dëshirës së familjarëve, duke u riveshur me granit ose pllakë mermeri me trashësi 2 cm, ku shkruhen të dhënat e identitetit të kufomës: emri, mbiemri, data e lindjes dhe data e vdekjes.

12. Në varrimet mbitokësore, dyshemeja e vendosjes së arkivolit duhet të jetë e prirur nga brenda në pjerrësinë 2 %, në mënyrë që të ndalohet ndonjë rrjedhje e mundshme lëngjesh.

13. Varrimet mbitokësore kryhen nga ndërmarrja që administron varrezat. Në përfundim të periudhës së dekompozimit, mund të bëhen zhvarrimet mbitokësore, duke i rivarrosur kufomat ose eshtrat, sipas të gjitha rregullave të ligjit.

14. Kur nga zhvarrimi mbitokësor rezulton që kufoma është mineralizuar plotësisht, eshtrat mund të futen direkt në kasën e tyre dhe të vendosen në vendet e posaçme të varrimit mbitokësor.

15. Zhvarrimet mbitokësore bëhen nën kontrollin e autoritetit sanitar vendor, i cili vendos për transferimin e kufomës ose eshtrave, pa ndonjë rrezik për shëndetin publik.

16. Në varrezat mbitokësore ka edhe seksione të veçanta për vendosjen e eshtrave njerëzore individuale, të nxjerra nga zhvarrimet nëntokësore dhe mbitokësore, në përfundim të periudhës së dekompozimit të kufomave. Edhe këto ndërtohen me dhomëza dhe me kate.

17. Eshtrat dhe mbetjet mortale të nxjerra nga zhvarrimet, vendosen menjëherë nëpër kaseta zingato me spesor jo më të vogël se 0,66 mm, mbyllen me saldim dhe futen nëpër dhomëza, ku shënohen dhe të dhënat identifikuese të tyre.

18. Kur eshtrat dhe mbetjet mortale, janë të gjetura dhe të paidentifikuara, mbyllen në kaseta dhe futen në dhomëza, duke shënuar vendin dhe datën ku këto janë gjetur.

19. Dhomëzat e vendosjes së eshtrave ndërtohen në seri njëra mbi tjetrën me kate. Ato ndërtohen me beton ose parafabrike dhe kanë formën e një paralelopipedi me gjatësi 0,70 m, gjerësi 0,30 m dhe lartësi 0,30 m. Trashësia e pareteve anësore është 5 cm. Mbyllja e tyre bëhet me granit ose mermer ku shënohen të dhënat e identitetit të eshtrave të kufomës.

20. Dhomëzat që përdoren për të vendosur eshtrat e zhvarrimeve, ndërtohen edhe në pjesën e brendshme të murit rrethues të varrezave nëntokësore, sipas dimensioneve të mësipërme. Kështu lartësia e murit rrethues (2,5-4 m) shfrytëzohet për ndërtimin e disa kateve të dhomëzave të eshtrave të zhvarrimeve. Në këtë mënyrë nga zhvarrimet lirohen vende për varrime të reja nëntokësore dhe hapësira e murit rrethues të varrezave shfrytëzohet për ndërtimin e dhomëzave me më pak shpenzime.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I RREGULLIMIT TË TERRITORIT DHE I TURIZMIT
Bashkim Fino

UDHËZIM
Nr.4, datë 7.7.2005

**PËR PROCEDURAT E BLERJES SË BANESAVE NË TREG NGA ENTI KOMBËTAR I
BANESAVE**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të pikës 3 të nenit 14 të ligjit nr.9416, datë 20.5.2005 “Për procedurat e privatizimit të banesave të ndërtuara ose të blera me fonde shtetërore nga Enti Kombëtar i Banesave”, Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit

UDHËZON:

1. Blerja e apartamenteve në tregun e lirë realizohet nga qytetari brenda vlerës kufi të përcaktuar nga Enti Kombëtar i Banesave sipas pikës 2 të këtij udhëzimi.

2. Vlera kufi e blerjes përcaktohet në bazë të formulës:

$$V_k = S_{ap} \times K_m \times "K"$$

Sap - sipërfaqja e shfrytëzimit të apartamentit.

Km - kostoja mesatare për sipërfaqe mesatare shfrytëzimi.

“K” - Koeficienti korrigjues, përcaktuar në pikën 3 të nenit 4 të ligjit nr.9416, datë 20.5.2005 “Për procedurat e privatizimit të banesave të ndërtuara ose të blera me fonde shtetërore nga Enti Kombëtar i Banesave”.

3. Qytetari i miratuar nga këshilli bashkiak për t’u trajtuar me strehim, me vënien në dijeni të vlerës kufi nga Enti Kombëtar i Banesave, përcaktuar sipas pikës 2 të këtij udhëzimi dhe strukturës së apartamentit që përfiton, bën zgjedhjen e apartamentit në treg. Përpara kryerjes së veprimeve përkatëse ligjore midis palëve, Enti Kombëtar i Banesave bën inspektimin e banesës.

4. Midis Entit Kombëtar të Banesave dhe qytetarit shitës nënshkruhet kontrata e shitblerjes përpara noterit në bazë të aktit të pronësisë të paraqitur prej tij. Akti i pronësisë duhet të vërtetojë se prona nuk ka barrë hipotekore.

5. Me kalimin e banesës në pronësi të Entit Kombëtar të Banesave lidhet kontrata midis qytetarit blerës dhe Entit. Në momentin e lidhjes së kontratës qytetari blerës detyrohet t’i paguajë Entit Kombëtar të Banesave shumën prej 4% të vlerës së banesës për shpenzimet operationale.

6. Procedura e blerjes së banesës do të kryhet nga degët e Entit Kombëtar të Banesave brenda një afati 4-mujor nga momenti i vënies në dispozicion të fondit përkatës.

7. Qytetarët që përfitojnë sipas këtij udhëzimi, kur nuk kryejnë veprimet për blerjen e banesave brenda afati të përcaktuar në pikën 6 të këtij udhëzimi, u humbet e drejta për trajtim me strehim. Ky afat mund të shtyhet edhe për një muaj, nëse janë paraqitur arsye objektive (nuk gjen dot banesë në treg; qytetari që do të trajtohet me strehim nuk ndodhet brenda vendit etj.).

8. Ngarkohet Drejtoria e Strehimit në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Enti Kombëtar i Banesave dhe organet e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I RREGULLIMIT TË TERRITORIT DHE I TURIZMIT
Bashkim Fino

VENDIM
Nr.5, datë 8.3.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 8.2.2005, mori në shqyrtim, mbi bazë të dokumenteve, çështjen nr.16 Akti që i përket:

KËRKUES: GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SHKODËR

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i togfjalëshit “... më shumë se një herë”, parashikuar në nenin 278, paragrafi i katërt i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 34 e 145/2 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin Kujtim Puto, shqyrtoi vendimin e datës 27.10.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, dokumentet e tjera të çështjes dhe e bisedoi atë në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, bazuar në nenin 145/2 të Kushtetutës, ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Renato Jovani, akuzuar për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, sipas nenit 278 të Kodit Penal, dhe i ka dërguar çështjen Gjykatës Kushtetuese për t’u shprehur për papajtueshmërinë me Kushtetutën të togfjalëshit “... më shumë se një herë”, parashikuar në paragrafin e katërt të këtij neni. Sipas gjykatës së rrethit, dënimi i një personi të dënuar më parë për të njëjtën veprë sipas nenit 278/4 (më shumë se një herë) të Kodit Penal, vjen ndesh me parimin kushtetues të mosdënimit dy herë për të njëjtën veprë penale (parimi *ne bis in idem*), parashikuar në nenin 34 të Kushtetutës dhe në nenin 4 të protokollit nr.7 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Parimi “*ne bis in idem*” është njohur nga e drejta jonë e brendshme dhe nga e drejta ndërkombëtare penale si një prej të drejtave të njeriut të mbrojtura nga Kushtetuta dhe nga instrumentet kryesore juridike të brendshme e ndërkombëtare që rregullojnë marrëdhëniet në fushën penale, si dhe përgjegjësinë për kundërvajtje. Sipas këtij parimi, “individit nuk mund të ndiqet e nuk mund të gjykohej nga juridiksionet e të njëjtit shtet për një shkelje, për të cilën është shpallur më parë i pafajshëm apo është dënuar në bazë të një vendimi gjyqësor përfundimtar të ligjshëm”.¹

Pranimi i parimit të mësipërm në gjykimin dhe vendimmarrjen për një çështje penale kërkon përmbushjen e dy kritereve që janë, ai i veprës penale “të njëjtë” me të mëparshmen dhe ai i kryerjes së saj “përsëri”.

Kriteri “e njëjta veprë” i referohet të njëjtit veprim, sjellje, fakt, veprë penale dhe kualifikim ligjor të tyre, të cilat formojnë bazën e kësaj vepre dhe për të cilin personi është dënuar apo liruar. Në këtë rast, është fjala kur si sjellja, ashtu edhe krimi bëhen për të njëjtat fakte të ndodhura në të njëjtën kohë dhe që cilësohen njëloj nga ligji.

Duke u nisur nga interpretimet e mësipërme rezulton se ky parim nuk mund të gjejë zbatim në rastet kur të dy veprat penale nuk kanë elemente të njëjta. Nëse gjenden elemente të njëjta, parimi “*ne*

¹ (Vendimi i datës 14.9.1999, Dhoma (Seksioni) i III të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, ankimet nr.36855/97 dhe 41731.98).

bis in idem” ndalon çdo dënim tjetër apo procedim të mëtejshëm.

Sipas kuptimit të mësipërm, kur me vendim të formës së prerë është vendosur për një çështje, atëherë ajo nuk mund të gjykohet përsëri. Ky rregull është i vlefshëm edhe për të gjitha gjykatat e tjera brenda kufijve të të njëjtit juridiksion.

Nga ana tjetër, parimi “*ne bis in idem*”, që ndalon rigjykimin e ridënimit për të njëjtën vepër, nuk gjen zbatim në rastet kur i njëjti veprim përbën dhunim të dy dispozitave të ndryshme ligjore. Për të njëjtat shkelje mund të zhvillohen procese me karaktere të ndryshme, penale dhe disiplinor. I njëjti veprim mund të konsiderohet si në shkelje e të dy ligjeve (normave) edhe në rastet kur njëri prej tyre kërkon provën e një fakti shtesë që ligji (norma) tjetër nuk e ka të nevojshme. Në këtë rast, pafajësia apo dënimi në bazë të njërit ligj nuk e përjashton ndëshkimin sipas tjetrit¹.

Neni 34 i Kushtetutës dhe neni 7 i protokollit të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut nuk janë pengesë gjithashtu për gjykimin e dënimit e personave që kryejnë sjellje kriminale të njëpasnjëshme edhe nëse sjelljet janë të ngjashme ndërmjet tyre. Ideja e parimit në “*bis in idem*” nuk qëndron te zbatimi dy a më shumë herë i të njëjtës normë penale, por te mosgjykimi e mosdënimi përsëri i subjektit për të njëjtën vepër penale, për të cilën ai është dënuar më parë me një vendim i formës së prerë nga një gjykatë e ligjshme. Megjithatë, aktet e mësipërme lejojnë rigjykimin, kur dalin fakte të reja, të cilat janë të një natyre të tillë që mund të cenojnë vendimin e dhënë. Në këtë rast e drejta për rishqyrtim nuk mund të bazohet mbi skema logjike të supozuara në mënyrë apriori, por mbi kritere praktike të mundshme.

Parimi “*ne bis in idem*”, si dhe trajtimi i barabartë i të gjykuarve cenohen jo vetëm kur personi dënohet përsëri për të njëjtën vepër, por edhe kur ndiqet penalisht në mënyrë të përsëritur për këtë vepër. Prandaj, ky parim gjen zbatim edhe për rastet e mbrojtjes nga masat shtrënguese e ndaluese, të cilat janë të lidhura ngushtë me procedimin. Përkundrazi, një person që është thirrur si i pandehur dhe është dënuar penalisht gjatë një procesi mund t’i nënshtrohet një procesi të dytë civil për të njëjtën vepër si përgjegjës civilisht për dëmin e shkaktuar ose si i dënuar me gjobë duke u zbatuar parimi që “gjëja e gjykuar është e vërtetë”.

Gjykata Kushtetuese, duke përdorur si metodë interpretimin e dispozitave të Kodit Penal për të vlerësuar kushtetutshmërinë e këtyre dispozitave, arrin në përfundimin se togfjalëshi “më shumë se një herë” parashikuar në nenin 278/4 të Kodit Penal, nuk vjen në kundërshtim me parimin e mosdënimit dy herë për të njëjtën vepër penale.

Në disa dispozita të këtij kodi, parashikohen forma të ndryshme të llogaritjes së dënimit për personat që kanë kryer vepra penale në mënyrë të përsëritur (recidivë) ose më shumë se një herë. Megjithatë, kjo nuk nënkupton edhe mundësinë e llogaritjes dy herë, njëkohësisht, e të njëjtave fakte e rrethana në kualifikimin e veprave penale. Ashtu siç thuhet edhe në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër subjekti i një veprë penale mund të jetë i dënuar i rehabilituar, i dënuar dhe ende i pa rehabilituar ose person që ka kryer disa herë vepra penale dhe nuk është dënuar për to. Togfjalëshi “më shumë se një herë” nuk do të thotë që i përfshin të tre këta grupe personash. Përkundrazi Kodi Penal në nenin 50 dallon rrethanën rëndonjëse të “kryerjes së një krimi pas dhënies së një dënimi për një krim të kryer më parë” (shkronja “ç”) nga rrethana tjetër rëndonjëse e “kryerjes së veprës penale më shumë se një herë” (shkronja “h”). Për më tepër sipas përmbajtjes së kreut të gjashtë të Kodit Penal që ka të bëjë me caktimin e dënimit, përsëritja konsiderohet si një rrethanë rënduese subjektive që ka të bëjë me personin e fajtorit, prandaj është lënë në vlerësimin e gjykatës përcaktimi i masës së rëndimit të fajtorit. Nëse ligjvënësi një nga rrethanat e mësipërme e pikërisht atë “më shumë se një herë” e ka parashikuar në disa raste edhe si element të veprës penale duke e bërë këtë të fundit të cilësuar, nuk do të thotë se ka përzier në të dhe rrethanat e tjera rënduese, që kanë të bëjnë me dënimin e mëparshëm. Përkundrazi ligjvënësi nuk ka përfshirë si element të veprës penale kryerjen e një krimi pas dhënies së një dënimi për një krim të kryer më parë, për të mos cenuar parimin *ne bis in idem*.

Vetë ky parim përjashton dënimin e përsëritur të një personi për të njëjtën vepër penale, prandaj në rastin kur për veprën e mëparshme i akuzuari është dënuar dhe madje ka vuajtur dënimin, elementet e veprës së mëparshme nuk mund të konsiderohen si pjesë përbërëse të veprës së re penale. Nëse në veprimtarinë praktike të gjykatave konstatohen raste të vlerësimit të dënimit dy ose më shumë herë për të njëjtat fakte e rrethana, këto janë probleme që nuk kanë të bëjnë me antikushtetutshmërinë e ligjit, por me interpretimin e zbatimin e tij, që vlerësohen e korrigjohen nga vetë gjykatat e sistemit

¹ (vendimi 282 US. 299/1932) për çështjen “Blochburger - Shteteve të Bashkuara”

gjyqësor.

Paragrafi i dytë i nenit 4 të protokollit të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut lejon që elementet dhe faktet e veprës së mëparshme të diskutohen vetëm në raste rigorozisht të përcaktuara: dalin fakte të reja ose të zbuluara rishtas, një ves themelor në procedurën e mëparshme që janë të një natyre të tillë që mund të cenojnë vendimin e dhënë. Nëse këto raste nuk vërtetohen, çështja e mëparshme nuk mund të diskutohet më dhe as të bëhet pjesë e elementeve të veprës së re.

Ndryshe qëndron problemi në rastet kur i akuzuari ka kryer edhe më parë vepër penale, por nuk është dënuar për të. Në këtë rast përcaktimi “më shumë se një herë” si element që e bën veprën penale të cilësuar dhe si rrjedhojë parashikimi i një dënimi më të ashpër në raport me atë që ka kryer vetëm një vepër penale nuk cenon parimin “*ne bis in idem*” dhe as atë të trajtimit të barabartë e të arsyeshëm të të gjykuarve, sepse i akuzuari duhet t’i nënshtrohet procesit gjyqësor për të dyja veprat.

PËR KËTO ARSYE;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe i detyrueshëm për zbatim.

VENDIM

Nr.14, datë 5.7.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 14.4.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.26 Akti, që i përket:

KËRKUES: VIOLENT ÇONIKU, përfaqësuar nga avokat Alfred Jorgji, me deklaram.

SUBJEKTI I INTERESUAR: PROKURORIA E PËRGJITHSHME, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.1865, datë 15.10.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

BAZA LIGJORE: Neni 43 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë

Për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të mësipërm të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, kërkuesi ka paraqitur këto shkaqe:

- Është cenuar e drejta për t’u ankuar kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë;
- Gjykata e Apelit ka vepruar si gjykatë e shkallës së parë, prandaj Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 43 të Kushtetutës, ishte i detyruar ta kalonte çështjen në seancë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Xhezair Zaganjori, kërkuesin dhe përfaqësuesin e tij, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kërkuesi ka qenë në detyrën e prokurorit në prokurorinë e rrethit Pukë. Pas propozimit me shkrim të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm, me dekret të Presidentit të Republikës datë 16.6.2003, ai është liruar nga detyra e mësipërme, me motivacionin “Për shkelje të ligjit në ushtrimin e detyrës”.

Bazuar në nenin 34 të ligjit nr.9102, datë 10.7.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë, duke kërkuar kundërshtimin e aktit të largimit nga detyra, si dhe shpërblimin e pagës për një vit. Me vendimin nr.40, datë 19.5.2004, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.

Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Me vendimin nr.1865, datë 15.10.2004, në dhomën e këshillimit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur “mospranimin e rekursit të paraqitur nga paditësi Violent Çoniku”, pasi “nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile”.

Në kërkesën e paraqitur pranë Gjykatës Kushtetuese, kërkuesi thekson se ky vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i marrë në dhomën e këshillimit, duhet të shfuqizohet si antikushtetues, pasi përmes tij është cenuar e drejta kushtetuese për t’u ankuar në një gjykatë më të lartë kundër një vendimi gjyqësor.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se, në rastin konkret, kemi të bëjmë me gjykimin kushtetues të një ankese individuale, pretendimet e së cilës duhet të shihen në kuadër të kërkesave apo standardeve kryesore që kërkon procesi i rregullt ligjor në kuptim të neneve 42 dhe 131/f të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe nenit 6 të Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut. Në këtë drejtim merren në konsideratë edhe karakteristikat e veçanta të procesit në fjalë, si dhe jurisprudenca e pasur e Gjykatës Kushtetuese në shqyrtimin e ankesave të kësaj natyre.

Nga ky këndvështrim, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se ankesa e V. Çonikut, duhet rrëzuar për këto arsye:

1. Në nenin 43 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë deklarohet shprehimisht se “Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe”.

Gjykata Kushtetuese thekson se e drejta e ankimit në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, duhet kuptuar si një mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar në një gjykatë më të lartë vendimin e dhënë ndaj tij nga një gjykatë më e ulët. Pra, me Kushtetutë, kujdo i garantohet e drejta për t’u ankuar të paktën një herë kundër çdo vendimi gjyqësor të dhënë ndaj tij.

Kjo garanci e rëndësishme kushtetuese është edhe një tejkalim pozitiv krahasuar me standardet që ofron në këtë drejtim Konventa Europiane e Drejtave të Njeriut. Në nenin 6 të kësaj Konvente nuk parashikohet e drejta për të pretenduar mjete ankimi kundër vendimeve gjyqësore, e për pasojë, as detyrimi i shteteve palë për të ngritur gjykata apeli ose rishikimi (Gjykata të Larta ose Kasacioni). Prandaj, sipas jurisprudencës së Strasburgut, nuk mund të konsiderohet cenim i këtij neni fakti nëse në rrugë ligjore, ligjvënësi i një prej shteteve palë në Konventë do të zëvendësonte ose anulonte (hiqte) një mjet ankimi ekzistues, të parashikuar në legjislacionin e tij.¹

Megjithatë, në nenin 2 të protokollit 7 të Konventës, vetëm për çështjet penale është parashikuar e drejta e çdo personi të dënuar për kryerjen e një veprë penale që të paraqesë të paktën një herë për shqyrtim në një gjykatë më të lartë çështjen e deklarimit të fajësisë ose të masës së dënimit të tij. Por, sipas paragrafit të dytë të nenit 2 të protokollit 7 të Konventës, edhe në këto raste, shtetet palë kanë liri mjaft të gjerë vlerësimi dhe veprimi për të përjashtuar nga e drejta e ankimit vepra të lehta penale ose rastet kur personi është gjykuar në shkallë të parë nga gjykata më e lartë etj.

¹ Shih Frowein–Peukert, EMRK–Komentar, 2.Auflage, Engel Verlag 1996, f.209.

Madje, edhe në rastet kur parashikohet shprehimisht e drejta e ankimit në çështjet penale, ato (pra shtetet palë) janë të lira ta vlerësojnë e lejojnë atë edhe për çështje të faktit dhe të ligjit ose ta kufizojnë vetëm për çështje të ligjit.¹

Megjithëse neni 6, si rregull, nuk garanton të drejtën e ankimit ndaj një vendimi gjyqësor, në rastet kur ai parashikohet si i tillë nga Kushtetuta apo legjislacioni i brendshëm i shteteve palë në këtë Konventë, “proceset që do të zhvillohen në gjykatat e apelit ose të kasacionit duhet të respektojnë me rigorozitet garancitë themelore të këtij neni.”²

Për aq sa është e mundur, këto kërkesa apo standarde duhet të zbatohen edhe në gjykimet që zhvillojnë gjykatat kushtetuese të këtyre shteteve.³

Në këtë kuadër dhe brenda këtyre standardeve, duhet të shihet edhe e drejta e ankimit. Për këto arsye, kufizimet e mundshme që mund t’i bëhen njohjes dhe ushtrimit të kësaj të drejte (pra të drejtës së ankimit), nga legjislacioni i brendshëm, në analogji me të drejtën e aksesit në gjykatë që garanton paragrafi i parë i nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, duhet të plotësojnë dy kushte themelore: të ndjekin një qëllim të ligjshëm dhe të mos cenojnë thelbin e kësaj të drejte (të drejtës së ankimit).⁴

Përveç sa më sipër, si për çdo të drejtë tjetër të garantuar nga Konventa, sipas jurisprudencës së Strasburgut, është mëse e domosdoshme që për çdo realitet konkret, legjitimitimi ose jo i ndërhyrjes duhet të vlerësohet lidhur ngushtë me parimin e proporcionalitetit apo domosdoshmërisë së këtij kufizimi në një shoqëri demokratike.

Në rastin në gjykim, këto kriteret duhet të ballafaqohen para së gjithash me kërkesat e nenit 17 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë sipas të cilit, kufizimet e të drejtave dhe lirive kushtetuese mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, duke qenë gjithnjë në përpjestim me gjendjen që i ka diktuar. Ato nuk mund të cenojnë thelbin e së drejtës dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Shihet qartë se kriteret e Konventës për kufizimin e mundshëm të së drejtës së ankimit, përfshihen plotësisht brenda kërkesave të nenit 17 të Kushtetutës lidhur me kufizimet e të drejtave dhe lirive kushtetuese. Për më tepër, sipas këtij neni, kufizimet e këtyre të drejtave duhet të kenë si pikë maksimale referimi, pikërisht standardet e kësaj Konvente.

2. Në nenin 34/2 të ligjit nr.9102, datë 10.7.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, theksohet se “Në rastet e shkarkimit nga detyra, prokurori mund të bëjë ankim në Gjykatën e Apelit ...”. Siç shihet, përjashtimisht nga rregulli i përgjithshëm procedural i gjyimit të çështjeve gjyqësore, për herë të parë në gjykatën e shkallës së parë, ligjvënësi ka parashikuar që çështje të kësaj natyre, ashtu si edhe disa çështje të tjera, të gjykohen direkt në gjykatën e apelit. Pra, në këto raste juridiksioni i saj është fillestar, prandaj, për aq sa është e mundur, gjykata e apelit zbaton dispozitat respektive procedurale të gjyimit në shkallë të parë.

Qëllimi kryesor i këtij përjashtimi është shkurtimi i afateve për zgjidhjen e këtyre çështjeve, duke garantuar njëkohësisht edhe një gjykim fillestar më të kualifikuar e më profesional. Është në interes të administrimit të drejtësisë dhe të funksionimit normal të mekanizmave shtetërore që rastet e këtij lloji, mjaft të kufizuara në numër dhe relativisht të lehta për t’u zgjidhur, të trajtohen me përparësi dhe vëmendje të veçantë. Ky përjashtim është në përputhje edhe me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, në të cilët, ndër të tjera, kërkohet zhvillimi i gjyimit brenda një afati sa më të arsyeshëm.

Në rastin konkret, në përputhje me nenet 29 dhe 30 të ligjit nr.9102, datë 10.7.2003, kërkuesi është njohur me dokumentacionin e procedimit, është dëgjuar në Këshillin e Prokurorisë ku i është dhënë mundësia të mbrohet duke paraqitur argumente dhe prova që ka çmuar të dobishme dhe të nevojshme.

Më pas, sipas ligjit, ai i është drejtuar gjykatës së apelit, e cila e ka gjykuar çështjen dhe ka dhënë vendimin e saj. Nga dosja gjyqësore dhe nga natyra e pretendimeve të mëvonshme të kërkuesit

¹ Shih Krombach kundër Francës, vendimi datë 13.2.2001, botuar në “Reports of Judgements and Decisions, 2001-II.

² Shih Monnell & Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendimi datë 2.03.1987, Seria A, nr.115.

³ SHih Frowein-Peukert, op.cit. f.169-170.

⁴ Shih. Haser kundër Zvicrës, vendimi 27.04.2000, cituar në çështjen Krombach kundër Francës, op.cit.

në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë duket qartë se në këtë gjykatë janë respektuar të gjitha kërkesat themelore të procesit të rregullt ligjor sipas standardeve të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Procesi gjyqësor në gjykatën e apelit ka qenë me gojë dhe publik; kërkuesi është mbrojtur vetë dhe me avokat; janë respektuar parimet e barazisë dhe të kontradiktoritetit; vendimi është marrë në bazë të administrimit dhe vlerësimit të provave që janë konsideruar si të nevojshme nga gjykata etj. Kërkuesi nuk ka pasur asnjë pretendim apo kundërshtim lidhur me pavarësinë dhe paanësinë e gjykatës në këtë gjykim.

Më pas, kërkuesi ka kundërshtuar këtë vendim në Gjykatën e Lartë, duke iu drejtuar asaj me anë të rekursit, si një nga tre mjetet e ankimit ndaj vendimeve të gjykatave, të parashikuara në nenin 442 të Kodit të Procedurës Civile. Sipas këtij Kodi, rekursi është i vetmi mjet me të cilin palët ose pjesëmarrësit e tjerë në proces mund të parashtrajnë në Gjykatën e Lartë kundërshtimet e tyre ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë ose gjykatës së apelit (neni 442/b i Kodit të Procedurës Civile).

Gjykata Kushtetuese konstaton gjithashtu se në ligjin nr.9102, datë 10.7.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, nuk parashikohen procedura të ndryshme për trajtimin e këtyre çështjeve në Gjykatën e Lartë. Prandaj, kjo Gjykatë është e detyruar të zbatojë procedurat e zakonshme të gjykimit të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.

Në këtë drejtim duhet pasur parasysh edhe karakteri i veçantë i shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Lartë. Ajo nuk përsërit gjykimet e zhvilluara në gjykatën e shkallës së parë apo atë të apelit, pra nuk e trajton çështjen edhe nga pikëpamja e faktit, por kufizohet kryesisht në çështjet ligjore, në mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga këto gjykata. Gjykata e Lartë kontrollon nëse, në gjykimet e mëparshme, janë zbatuar ose jo kërkesat e ligjit.¹

Pra, ankimi (rekursi) në Gjykatën e Lartë, faktikisht, kufizohet në çështje të ligjit. Sipas Kodit të Procedurës Civile, kjo do të thotë që kundërshtimet e paraqitura në rekurs duhet të shqyrtohen fillimisht nga kolegji i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve, dhe nëse ai nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon ligji (neni 472 i Kodit të Procedurës Civile), në bazë të nenit 480 të Kodit të Procedurës Civile, ky kolegji vendos mospranimin e tij, ashtu siç është vepruar edhe për rastin në gjykim.

Nga sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kjo mënyrë e shqyrtimit të çështjes dhe moskalimi i saj në seancë me anë të vendimit të marrë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, nuk përbën shkelje të së drejtës kushtetuese të ankimit ndaj një vendimi gjyqësor. Kjo e drejtë, praktikisht, i është kufizuar në mënyrë të arsyeshme kërkuetit, por pa u prekur në thelbin e saj. Në këndvështrimin formalo-juridik, kërkuesi e ka ushtruar atë në një masë të caktuar dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Ai i ka paraqitur pretendimet e tij në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Këto pretendime janë shqyrtuar nga kolegji civil i kësaj gjykate, në dhomën e këshillimit, dhe mbi këtë bazë, është vendosur moskalimi i çështjes në seancë gjyqësore.

Një qëndrim i tillë është në përputhje të plotë edhe me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe me jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut. Kjo jo vetëm në këndvështrim të hapësirës së gjerë të vlerësimit që u lihet shteteve për të kufizuar të drejtën e ankimit, siç është trajtuar më lart, por edhe të mundësisë së mosshqyrtimit të këtij ankimi në seancë publike. Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në një sërë rastesh ka theksuar ndër të tjera se moszhvillimi i një procesi publik në shkallët më të larta të gjykimit mund të përligjet nga veçantia e procedurave të veçanta të çështjes, por me kusht që procesi i zhvilluar në shkallën e parë të ketë qenë publik. Për këtë arsye, edhe procesi që mund të zhvillohet në këto gjykata pa praninë e palëve dhe në bazë të një ankimi vetëm për çështje të zbatimit të ligjit, konsiderohet si në përputhje të plotë me kërkesat e nenit 6 të Konventës.²

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për

¹ Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.25/2003.

² Shih Monnell dhe Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendimi datë 2 mars 1987, seria A, nr.115 dhe Sutter kundër Zvicrës, vendimi datë 22 shkurt 1984, seria A, nr.74

organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr.1, datë 25.3.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbëra nga:

Thimjo Kondi	Kryetar
Kristaq Ngjela	Anëtar
Perikli Zaharia	Anëtar
Spiro Spiro	Anëtar
Agron Lamaj	Anëtar
Artan Hoxha	Anëtar
Nikoleta Kita	Anëtare
Ylvi Myrtja	Anëtar
Valentina Kondili	Anëtare
Vladimir Metani	Anëtar
Vladimir Bineri	Anëtar
Irma Bala	Anëtare
Shpresa Beçaj	Anëtare
Besnik Imeraj	Anëtar
Ardian Dvorani	Anëtar

në seancën gjyqësore të datës 25.3.2005 morën në shqyrtim çështjen penale që i përket:

TË PANDEHURVE: EDI BIBA, PAULIN PRENGA, TONIN PJETRI

AKUZA: Kryerja e veprave penale të rrëmbimit të personit, në bashkëpunim, dhe mbajtje e armëve pa leje, parashikuar nga nenet 109, paragrafi i parë, nenet 25 dhe 279, paragrafi i dytë të Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mirditë, me vendimin nr.100, datë 10.11.2003, ka vendosur:

Pushimin e gjykimit të çështjes penale për të pandehurin Edi Biba, për veprën penale të vetëgjyqësisë, të kryer në bashkëpunim, sipas nenit 277 e 25 të Kodit Penal, pasi është amnistuar.

Pushimin e gjykimit të çështjes penale për të pandehurin Tonin Pjetri, për veprën penale të vetëgjyqësisë, të kryer në bashkëpunim, sipas nenit 277 e 25 të Kodit Penal, pasi është amnistuar.

Pushimin e gjykimit të çështjes penale për të pandehurin Paulin Prenga, për veprën penale të vetëgjyqësisë, të kryer në bashkëpunim, sipas nenit 277 e 25 të Kodit Penal, pasi është amnistuar.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Paulin Prenga për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe, në bazë të nenit 278 paragrafi i dytë i Kodit Penal, dënimin e tij me 5 muaj burgim, dënim i cili është vuajtur.

Deklarimin e pafajshëm të të pandehurve Edi Biba e Tonin Pjetri për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuar nga neni 278, paragrafi i dytë i Kodit Penal.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.163, datë 11.3.2004 ka lënë në fuqi vendimin

nr.100, datë 10.11.2003 të Gjykatës së Rrethit gjyqësor Mirditë.

Kundër këtyre vendimeve ka paraqitur rekurs prokurori, i cili kërkon ndryshimin e tyre dhe deklarimin fajtor të tre të pandehurve për veprën e heqjes së paligjshme të lirisë në bashkëpunim, parashikuar nga neni 110, paragrafi i dytë i Kodit Penal dhe dënimin e secilit me 3 vjet burgim, duke parashtruar këto shkaqe:

- Të dyja gjykatat nuk kanë marrë në analizë elementet e veprës penale të heqjes e paligjshme të lirisë dhe ndryshimet që kjo vepër ka me atë të vetëgjyqësisë, si dhe konkurrimin e veprave në rastin konkret.

- Të pandehurit, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, i kanë hequr në mënyrë të paligjshme lirinë të dëmtuarit Besnik Lleshi, duke e marrë, futur me dhunë në makinë, më pas e kanë nxjerrë nga makina dhe kanë ecur rrugës së malit së bashku, dhe e kanë lëshuar vetëm nga frika e policisë. Po të mos ishte ndërhyrja e policisë, të pandehurit nuk kishin për ta lëshuar të dëmtuarin.

- Vetëgjyqësia, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, si vepër, drejtohet kundër pasurisë apo interesave të tjera që i pandehuri mendon se i takon, pa i zgjidhur në rrugë ligjore, por jo kundër personit. Po qe se gjatë kryerjes së veprës së vetëgjyqësisë ushtrohet dhunë në formë të ndryshme ndaj personit, ku mund të shkaktohen dëmtime trupore, apo hiqet liria, këto veprime konkurrojnë me vetëgjyqësinë, prandaj të pandehurit duhet të përgjigjen për veprën penale të vetëgjyqësisë dhe heqjes së paligjshme të lirisë, të kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 277 e 25, si dhe 110 paragrafi i dytë i Kodit Penal.

Në gjykimin e çështjes në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, prokurori ndryshoi përsëri qëndrim lidhur me kualifikimin e veprës penale nga heqje e paligjshme e lirisë dhe vetëgjyqësi, në rrëmbim personi të kryer në bashkëpunim, neni 109 e 25 të Kodit Penal. Ai arsyeton se veprimet e të gjykuarve i përgjigjen plotësisht elementeve të anës objektive të veprës penale të rrëmbimit të personit, që bëhet jo vetëm për të fituar pasuri, por edhe për të realizuar kushte a kërkesa të tjera e çdo qëllim tjetër.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.506/6 Akti, datë 26.1.2005, e ka dërguar çështjen në Kolegjet e Bashkuara për përcaktimin e saktë të praktikës gjyqësore, lidhur me cilësimin juridik të veprës penale dhe të interpretimit gjyqësor të dispozitave të nenit 109, 110 dhe 277 të Kodit Penal.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Artan Hoxha dhe Valentina Kondili, prokurorin Bujar Sheshi, i cili kërkoj ndryshimin e vendimit të gjykatës së apelit dhe deklarimin fajtorë të të gjykuarve për veprën penale të rrëmbimit të personit të kryer në bashkëpunim, neni 109/1 e 25 i Kodit Penal,

mbrojtësin e të gjykuarit Tonin Pjetri, avokatin Viktor Ikononi, i cili kërkoj lënien në fuqi të vendimit,

dhe pasi e biseduan çështjen në tërësi,

VËREJNË:

Nga gjykimi i çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mirditë dhe Gjykatën e Apelit Tiranë, rezultojnë të provuara faktet dhe rrethanat e mëposhtme:

I dëmtuari Besnik Lleshi kishte punuar në Itali me vëllanë e të gjykuarit Tonin Pjetri, Altin Pjetrin, i cili i kishte dhënë 10 milionë lireta që t'ia dërgonte familjes së tij. Njëkohësisht, Altini kishte njoftuar familjarët nëpërmjet telefonit për dërgimin e parave dhe i kishte sqaruar që një pjesë të shumës t'ia jepin të gjykuarit Edi Biba, për shlyerjen e një borxhi.

Duke parë se i dëmtuari nuk po i sillte të hollat, pasi me to kishte blerë një makinë, i gjykuari Tonin Pjetri, së bashku me dy të gjykuarit e tjerë Edi Biba dhe Paulin Prenga, më datë 25.9.2001, kanë shkuar në një lokal në fshatin Fierzë, ku i dëmtuari drekonte me dy shokë të tij, me forcë dhe nën kërcënimin e armës e kanë marrë me vete. Në vijim të veprimeve të tyre, kanë hipur në dy makina, në atë tip "BMW" të vetë të dëmtuarit dhe një tjetër tip "Golf" dhe janë nisur në drejtim të fshatit Pllane, Lezhë. Duke qenë se policia, e lajmëruar nga shokët e të dëmtuarit, është vënë në ndjekje të tyre, në fshatin Pllane ata kanë lënë makinat dhe janë ngjitur një pjesë rruge me këmbë në drejtim të malit. Më

pas, duke qenë të ndjekur nga policia, e kanë lënë të lirë dhe pasi kanë hedhur armën dhe janë larguar duke iu fshehur ndjekjes.

Për sa më sipër, të gjykuarit janë akuzuar nga organi i prokurorisë për veprën penale të rrëmbimit të personit të kryer në bashkëpunim, si dhe armëmbajtjes pa leje.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mirditë, duke i pranuar rrethanat e çështjes si më sipër, i ka bërë një cilësim të ri juridik veprës nga rrëmbim i personit në vetëgjyqësisë, me arsyetimin se të tre të gjykuarit nuk e rrëmbyen të dëmtuarin për të realizuar ndonjë përfitim në të holla, por vetëm për të bërë të mundur dhënien prej tij të shumës së të hollave të dërguara nga Italia dhe që u përkisnin atyre. Nga ky fakt që nuk mohohet nga i dëmtuari, rezulton se mungon qëllimi i përfitimit në dëm të një tjetri, që në veprën e rrëmbimit duhet të jetë i pranishëm.

Të njëjtin arsyetim ka bërë edhe Gjykata e Apelit Tiranë, e cila ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë.

Organi i prokurorisë në rekurs ka pretenduar se vepra penale e vetëgjyqësisë konkurren me atë të heqjes së paligjshme të lirisë, për faktin se gjatë vetëgjyqësisë është ushtruar dhunë ndaj personit dhe i është hequr liria, prandaj të gjykuarit duhet të dënohen edhe për këtë veprë.

Ndryshe sa është parashtruar në rekurs, prokurori i seancës në Kolegjin Penal, kërkoi përsëri ndryshimin e kualifikimit të veprës në rrëmbim personi, neni 109/1 dhe 25 i Kodit Penal, duke arsyetuar se veprimet e të gjykuarve i përgjigjen plotësisht elementeve të anës objektive të veprës së rrëmbimit të personit, që bëhet jo vetëm për të fituar pasuri, por edhe për të realizuar kushte a kërkesa të tjera, a çdo qëllim tjetër.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë diskutoi çështjen në fjalë dhe vëren se ka mendime të kundërta lidhur me interpretimin dhe cilësimin ligjor të veprës së kryer nga të gjykuarit, nëse është “rrëmbim personi”, “heqje e paligjshme e lirisë”, “vetëgjyqësi”, apo konkurren i tyre me njëra-tjetrën.

Për sa më sipër, nisur nga mendimet e kundërta që ekzistojnë ndërmjet gjykatave, organit të prokurorisë dhe në praktikën gjyqësore në tërësi, Kolegji Penal çmoi se kjo çështje duhet të kalojë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara për unifikim të praktikës gjyqësore.

Nisur nga këto fakte dhe rrethana, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se vendimet e të dy gjykatave janë rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit.

Nga analiza dhe interpretimi i dispozitave të Kodit Penal, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se vepra penale e kryer nga të gjykuarit nuk është ajo e rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit parashikuar në nenin 109 të Kodit Penal, por ajo e heqjes së paligjshme të lirisë dhe vetëgjyqësia, parashikuar nga nenet 110 dhe 277 në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal. I gjykuari Paulin Prenga ka konsumuar edhe veprën penale të mbajtjes së armës pa leje parashikuar në nenin 279, paragrafi i dytë i Kodit Penal.

Në arritjen e përfundimeve të saj, në gjykimin e kësaj çështje, Kolegjet çmojnë se analiza e anës subjektive të veprave penale është vendimtare për të bërë kualifikimin e saktë të veprës penale të kryer nga të gjykuarit. Nga vendimet e gjykatave rezulton e pranuar dhe e provuar se qëllimi i veprimeve kriminale të kryera nga të gjykuarit ishte ushtrimi i një të drejte, pa iu drejtuar organeve kompetente apo gjykatës, për të marrë një shumë të hollash që, ndonëse njëhej si detyrim kundrejt tyre, i dëmtuari nuk ua kish dhënë dhe e mbante padrejtësisht.

Këto elemente dhe rrethana të anës subjektive, duke u shqyrtuar dhe analizuar së bashku me elemente e rrethana të tjera të anës objektive, gjithashtu bëjnë të mundur dallimin ndërmjet veprave penale të lartpërmendura, si dhe konkurren os jo ndërmjet tyre.

Kolegjet e Bashkuara, për të arritur në përfundimet e saj dhe për qëllime të njehsimit të praktikës gjyqësore, çmojnë të domosdoshme analizën dhe interpretimin e elementeve të figurës së të tri veprave penale, atë të rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit, neni 109, heqjen e paligjshme të lirisë, neni 110 dhe vetëgjyqësinë, neni 277.

Heqja e paligjshme e lirisë, neni 110 i Kodit Penal, parashikon mbrojtjen e përgjithshme të lirisë së personit kundrejt çdo lloj privimi të saj, dhunimit dhe nënshtrimit të detyrueshëm fizik nga cilido, veprime këto që nuk janë të autorizuar apo të lejuara nga ligji.

Motivi, veprimet a mosveprimet e autorit të kësaj vepre penale nuk janë të një natyre të përcaktuar shprehimisht prej saj. Heqja e paligjshme e lirisë mund të realizohet nëpërmjet veprimeve (aktive) duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në to: ushtrimi i dhunës mbi personin duke e rrëmbyer, mbajtur peng, e shoqëruar me bllokimin, prangosjen etj. ose në forma të tilla si injektimi i substancave narkotike që pamundësojnë reagimin dhe sjelljen normale të viktimës, dhunës psikike dhe

kanosjeve nëpërmjet përdorimit dhe drejtimit të armëve ndaj viktimës.

Nuk përjashtohen në heqjen e paligjshme të lirisë edhe përdorimi i formave të mashtrimit dhe gënjeshtërisë me synim dhunimin e lirisë apo vetëprivimin e viktimës nga liria personale për gjendjen e tij në situata të një sëmundjeje të pashërueshme, të rëndë, ngjithëse etj., në situata të një rreziku (që në fakt nuk ekziston), vendosjen në gjendje sugjestionimi a supersticioziteti etj.

Kjo veprë mund të kryhet edhe nëpërmjet mosveprimeve, kur nëpërmjet tyre mund të shkaktohet dhe realizohet heqja e paligjshme e lirisë. Në këto raste zbatimi i dispozitës shtrihet mbi ata persona (autorë) që kanë në ngarkim apo si detyrë të përcaktueshme mbrojtjen dhe garantimin e lirisë individuale të viktimës.

Heqja e paligjshme e lirisë (neni 110 i Kodit Penal), nga pikëpamja e anës subjektive realizohet për qëllime dhe motive që nuk janë nga ato të përfshira në nenin 109 të Kodit Penal, pavarësisht nëse janë a pretendohen të jenë të drejta a të ligjshme dhe pavarësisht nëse ato janë me natyrë pasurore, materiale ose të një natyre a marrëdhënie tjetër, që nuk kualifikohen si të tilla.

Nga pikëpamja e anës objektive heqja e paligjshme e lirisë (nënkupetohet rrëmbimi dhe mbajtja peng), pavarësisht nga mënyra e kryerjes, do të kuptohet si privim i lirisë së lëvizjes së personit në hapësirë sipas rrethanave dhe çmimit subjektiv të tij. Paprekshmëria e personit, liria e lëvizjes personale, për të mos u penguar a mbajtur fizikisht, por edhe psikologjikisht i lidhur nga një rrethanë e paligjshme dhe e dhunshme, është një e drejtë universale, natyrale, një nga liritë themelore të garantuar nga Kushtetuta.

Përsa i përket përcaktimit të heqjes së paligjshme të lirisë, ardhjes së pasojës dhe shkallës së tyre, është e rëndësishme të vërtetohet një kohëzgjatje e matshme dhe e mjaftueshme e privimit të lirisë, e cila jo domosdoshmërisht duhet të jetë e gjatë. Nuk përbën heqje të paligjshme të lirisë vërtetimi i kësaj gjendje objektive në një çast të caktuar ose kalimtar, me motivim dhe në kryerje e sipër të një veprimi të caktuar.

Gjithashtu, në kualifikimin e veprës penale të heqjes së paligjshme të lirisë, nuk ndikon shkalla relative apo absolute e heqjes së lirisë dhe as natyra e pengesave, bllokimit e përdorimit të mënyrave të tjera që bëjnë relativisht të përjashtuar ose të pamundur kapërcimin e tyre nga viktima apo mundësinë e vetëlirimit të tij.

Vepra penale e heqjes së paligjshme të lirisë, pavarësisht nga kohëzgjatja dhe shpjegimet e parashtruara më sipër, quhet e kryer që në çastin kur vërtetohet koha dhe vendi i realizimit të privimit dhe dhunimit të lirisë së personit.

Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit, neni 109 i Kodit Penal, synon të mbrojë në rradhë të parë lirinë e personit. Interpretimi dhe zbatimi korrekt i kësaj dispozite kërkon të mbahen parasysh ndërmjet të tjerave, dy elemente thelbësore:

a) përfitimi i padrejtë e realizimi i interesave të tjera të paligjshme në kuptim të rasteve të parashikuara nga dispozita dhe

b) lirimi i viktimës përkundërt marrjes së këtij përfitimi.

Edhe pse është e vendosur në seksionin VII “veprat penale kundër lirisë së personit”, neni 109 ka për objekt jo thjesht mbrojtjen e lirisë personale, por edhe paprekshmërinë dhe mbrojtjen e pasurisë. Veprimet dhe motivet e autorëve të veprës penale e kthejnë viktimën në një instrument, “send” të cenuar si qenie njerëzore dhe në interesat e tij pasurore e jopasurore. Ekziston një lidhje e ngushtë midis qëllimit të veprës, përfitimit dhe lirimit të personit për këtë shkak. Ai shkëmbehet, pra lihet i lirë, vetëm përkundërt realizimit të përfitimit të pasurisë, përfitimeve dhe qëllimeve të tjera të parashikuara në dispozitë.

Në aspektin subjektiv, ekzistenca ose jo e një marrëveshjeje apo marrëdhënie të mëparshme mes viktimës dhe autorit të veprës penale mund të përbëjnë edhe shkakun për kryerjen e veprës penale të rrëmbimit a mbajtjes peng të personit, por ky aspekt duhet të konsiderohet i përfshirë në qëllimin final të realizimit të një përfitimi të padrejtë e të paligjshëm, si një çmim, kompensim për lirimin e viktimës apo edhe për të lehtësuar gjendjen e të dëmtuarit që i është hequr liria në mënyrë të paligjshme.

Neni 109 është i qartë në këtë drejtim, sepse ligjvënësi ka përcaktuar vendimtar në kuptim të anës subjektive realizimin e qëllimit “... për të fituar pasuri ose çdo lloj përfitimi tjetër ...” dhe jo shkakun e saj. Pra qëllimi i përfitimit dhe lirimi i viktimës përkundërt realizimit të këtij qëllimi, përbëjnë në mënyrë të njëkohshme elemente thelbësore të kësaj vepre penale.

Neni 109 i Kodit Penal (ashtu sikurse edhe neni 110 i tij), duhet të konsiderohet i kryer me heqjen e paligjshme të lirisë, rrëmbimin a mbajtjen peng të viktimës, pavarësisht nëse autori ka arritur ose jo të realizojë përfitimet dhe qëllimet e parashikuara në veprë dhe përkundrejt të cilave ai do të lirojë viktimën.

Nëse gjatë gjykimit vërtetohet natyra e padrejtë e përfitimit si motiv për rrëmbimin a mbajtjen peng, jemi përpara rastit kur një person privohet nga liria, pra, rrëmbehet a mbahet peng dhe i kërkohet një përfitim i padrejtë përkundrejt liritë të tij. Në këtë rast është evidente lidhja e ngushtë ndërmjet veprimeve të kryera, qëllimit të përfitimit të padrejtë dhe kërkesës për të dhënë përfitimin përkundrejt liritë të viktimës. Prandaj, në këto raste Kolegjet çmojnë se figura e veprës penale që duhet të gjejë zbatim është ajo e rrëmbimit ose marrjes peng të personit, neni 109 i Kodit Penal.

Po ashtu, fakti që ka ekzistuar një kërkim a marrëdhënie e mëparshme qoftë edhe e paligjshme ndërmjet autorit të veprës dhe viktimës, shërben vetëm për të individualizuar llojin dhe masën e dënimit, por jo aspektet e tjera të anës subjektive që kërkon neni 109 i Kodit Penal, realizimi i një përfitimi të padrejtë përkundrejt liritë të viktimës.

Një nga elementet specifike që është dalluese dhe përcaktuese në kualifikimin e veprës, sipas nenit 109 apo nenit 110 të Kodit Penal, lidhet me anën subjektive të tyre, pikërisht me qëllimin, motivin e autorit të veprës penale dhe që ka të bëjë me realizimin e një përfitimi pasuror, përfitimeve a qëllimeve të tjera (të ngjashme). Kjo situatë del nga vetë kuptimi në tërësi i nenit 109 të Kodit Penal ku përfitimet dhe qëllimet duhet të jenë të padrejta, të përbëjnë një interes të paligjshëm, për vete ose për të tjerët, përkundrejt liritë të viktimës. Motivi dhe qëllimi i veprës sipas nenit 109 të Kodit Penal, lidhet me realizimin në mënyrë të padrejtë të një përfitimi pasuror, të një qëllimi tjetër të paligjshëm a në rrugë të paligjshme, përfshirë edhe qëllime të tjera të ngjashme me ato të përmendura shprehimisht në këtë dispozitë.

Ndërkohë, heqja e paligjshme e lirisë nuk i ka të përcaktuara motivet në kuptim të anës subjektive, gjë që do të thotë se ato janë të tilla që nuk përfshihen në nenin 109 të Kodit Penal ose në vepra të tjera penale.

Duke analizuar përmbajtjen e nenit 109 të Kodit Penal rezultojnë dy çështje thelbësore për anën objektive të kësaj vepre. Kështu, sjellja dhe veprimet e autorit sipas nenit 109 të Kodit Penal janë “rrëmbimi ose mbajtja peng e personit”, që në vetvete nuk janë gjë tjetër veçse veprime që kanë kuptim të njëjtë ose sjellin si pasojë heqjen e paligjshme të lirisë së viktimës. Nga ana objektive, kjo veprë penale nuk ka dallim substancial me atë të rrëmbimit të personit, pavarësisht se dy dispozitat përmbajnë fjalë e terma të ndryshme në pikëpamjen gjuhësore: “rrëmbim ose mbajtja peng” dhe “heqje e paligjshme e lirisë”. Edhe në rastin e nenit 110, nga pikëpamja e anës objektive, është e nënkuptuar se heqja e paligjshme e lirisë e përmban në vetvete ushtrimin e dhunës, kryerjen e veprimeve të tilla që çojnë në heqjen e lirisë dhe pamundësinë e personit për të “lëvizur” në liri. Këto veprime jo vetëm nuk përjashtojnë, por përfshijnë si rastet e mbajtjes peng e rrëmbimit të personit, ashtu edhe forma të tjera të privimit të lirisë pa ushtrim dhune fizike të përmendura më sipër në interpretimin e nenit 110 të Kodit Penal.

Në vijim të këtij interpretimi mund të bëhet edhe dallimi ndërmjet nenit 109 dhe nenit 109/b të Kodit Penal. Në rastin e nenit 109/b, ligjvënësi ka përcaktuar qartë se realizimi i anës subjektive, kryerja a moskryerja nga personi i një veprimi të caktuar, përfitimi ndaj tij ose në dëm të tij, padrejtësisht, i pasurisë ose çdo përfitimi tjetër, për vete ose të tretët, nga pikëpamje të anës objektive realizohet nëpërmjet kanosjes dhe formave të tjera të dhunës fizike, por që nuk sjellin si pasojë privimin, heqjen e paligjshme të lirisë personale të personit (viktimës). Ndërkohë që, në nenin 109, realizimin e anës subjektive ligjvënësi e lidh shprehimisht me ushtrimin e formave të veçanta të dhunës: rrëmbimit ose mbajtjes peng me pasojë privimin, heqjen e paligjshme të lirisë personale të viktimës.

Si në rastin e nenit 109, ashtu edhe për nenin 110 (por edhe neni 109/b) të Kodit Penal, vërtetimi i realizimit të qëllimit dhe motivit përkatës, ardhja e pasojave të parashikuara prej tyre, nuk përbëjnë elemente përcaktuese, për ekzistencën ose jo të veprës penale, por ajo quhet e kryer që nga momenti i heqjes së lirisë së personit.

Vetëgjyqësia, neni 277 i Kodit Penal parashikon ushtrimin e një të drejte nga personi që i përket ose që kujton se i përket dhe që nuk njihet nga tjetri, pa iu drejtuar organit kompetent shtetëror.

Kjo dispozitë synon jo vetëm të mbrojtë ushtrimin e autoritetit shtetëror, por edhe që të parandalojë e ndëshkojë sjelljet dhe veprimet shoqërisht të rrezikshme me të cilat autori i atribuon

vetvetes të drejtën për të realizuar një të drejtë a zgjidhur një mosmarrëveshje që ka me të dëmtuarin, duke shmangur rrugën e parashikuar nga ligji për t'iu drejtuar organit kompetent shtetëror. Në këtë kuptim, autori i veprës vepron duke shkelur dhe “zëvendësuar” veprimin e organit kompetent, i cili, nga ana e tij, ka juridiksionin, kompetencën dhe detyrën që të zgjidhë konfliktin mes palëve sipas ligjit, me objektivitet dhe paanshmëri. Ky veprim i autorit, në vetvete është i paligjshëm dhe arbitrar.

Nuk do të jemi përpara rastit të vetëgjyqësisë, ushtrimit arbitrar, të paligjshëm të së drejtës, nëse autori vepron, mbi sendin me synimin për të mbrojtur posedimin e ligjshëm dhe aktual të tij, të cenuar apo shqetësuar nga veprimi i paligjshëm i një personi të tretë, përderisa nuk jemi përpara detyrimit ligjor ose mundësisë për t'iu drejtuar organit kompetent shtetëror a gjykatës.

Pavarësisht se nuk përmendet shprehimisht në dispozitë, nga pikëpamja e anës objektive vetëgjyqësia kryhet nga autori nëpërmjet ushtrimit arbitrar të së drejtës, me forma të ndryshme të dhunës fizike a psikike (kanosjes, etj.), drejtpërdrejt mbi personin ose indirekt, duke vepruar mbi sendin a interesin mbi të cilin ekziston apo pretendohet se ekziston e drejta (e ligjshme) e autorit të veprës. Objekti mbi të cilin vepron autori jo domosdoshmërisht është ai për të cilin ushtron vetëgjyqësinë, mbi të cilin ai ka të drejtën a interesin e ligjshëm ose të pretenduar se i përket autorit.

Gjithashtu, është e rëndësishme që të ekzistojë mjeti, rruga ligjore dhe mundësia për autorin që të realizojë të drejtën e tij duke iu drejtuar organit kompetent shtetëror, e në veçanti gjykatës.

Duke analizuar sa më sipër rrethanat e faktit dhe elementet e figures së veprave penale të vëna në shqyrtim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimet e mëposhtme unifikuese:

Nëse mungon përfitimi i padrejtë, pra synohet a pretendohet të realizohet një interes i ligjshëm, përkundrejt ndërprerjes dhe dhunimit të lirisë (rrëmbimit a marrjes peng të viktimës), atëherë jemi përpara veprës penale të heqjes së paligjshme të lirisë, neni 110 i Kodit Penal, e cila konkurren me veprën penale të vetëgjyqësisë, neni 277 i Kodit Penal. Natyra e drejtë apo e padrejtë e përfitimit a interesit duhet të çmohet jo mbi bazën e vlerësimit personal të autorit të veprës, por nisur nga vlerësimi objektiv i tërësisë së rrethanave që rezultojnë në gjykimin e çështjes.

Nga pikëpamja e anës subjektive, vetëgjyqësia dallon edhe nga shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë, neni 109/b i Kodit Penal në rastin e nenit 109/b, autori synon një përfitim të padrejtë, është në dijeni dhe parashikon se ajo që synon të përfitojë apo pretendon të fitojë është e paligjshme dhe e padrejtë. Ndërsa autori i veprës në vetëgjyqësi synon të realizojë një të drejtë që i përket apo sipas rrethanave, pretendon se i përket atij dhe është i bindur sipas këtyre rrethanave (edhe pse mund të mos ketë të drejtë) se ajo që pretendon se i përket atij është e drejtë.

Dispozitat e neneve 109, 110 dhe 277 të Kodit Penal, parashikojnë mbrojtjen e marrëdhënieve shoqërore që cenojnë personin dhe pasurinë. Ndërkohë, në rastin e vetëgjyqësisë, mbrohen marrëdhëniet që lidhen me rendin dhe sigurinë publike. Është e kuptueshme se ligjvënësi bën një rregullim specifik, por edhe të ndërsjellë të marrëdhënieve të mbrojtura nëpërmjet këtyre dispozitave penale.

Në rastet e neneve 109 dhe 110, personi është cenuar në të drejtën e tij për të gëzuar lirinë personale. Rrëmbimi ose mbajtja peng janë forma të ushtrimit të dhunës fizike të shoqëruara ose jo me elemente të tjera të natyrës së dhunës psikike dhe që synojnë e sjellin si pasojë, një rezultat të vetëm: heqjen e paligjshme të lirisë personale. Për këto arsye, pavarësisht nga dallimi përse i përket anës subjektive, këto dy vepra penale nuk konkurrojnë me njëra-tjetrën.

Ndryshe nga nenet 109 dhe 109/b të Kodit Penal, në kuptim të anës subjektive, në nenin 277 të këtij Kodi, motivi dhe qëllimi lidhen me pretendimin për të mbrojtur një qëllim të drejtë a interes të ligjshëm. Në këtë rast, veprimet e njëjta a të ngjashme në kuptim të anës objektive nuk ndikojnë në përfundimin që neni 109 (por edhe neni 109/b) nuk konkurren me nenin 277 të Kodit Penal.

Në nenin 109, vepra kryhet nëpërmjet rrëmbimit a mbajtjes peng (që janë në vetvete elemente të heqjes së paligjshme të lirisë personale), ndërsa në nenin 109/b parashikohen elementet e tjera të dhunës psikike a fizike, që nuk janë ato të përmbajtura në nenin 109 të Kodit Penal. Në këtë kuptim, neni 109 nuk konkurren me nenin 109/b.

Nuk konkurrojnë me njëri-tjetrin as neni 109/b dhe neni 110 i Kodit Penal, për arsye se në rastin e parë kemi të bëjmë me veprime a mosveprime të autorit të veprës me motiv sigurimin e përfitimeve të padrejta, por pa i hequr lirinë viktimës së tij. Ndërsa në rastin e nenit 110, edhe pse motivi i kryerjes së veprës është i pakonkretizuar (raste që nuk përfshihen në nenin 109), thelbësor

është kryerja e saj duke i hequr në mënyrë të paligjshme lirinë viktimës.

Ndërkohë që konkurrojnë me njëri-tjetrin neni 110 me nenin 277, për arsyen thelbësore që vetëgjyqësia, neni 277, konsumohet për motive të mbrojtjes së një të drejte a interesi të ligjshëm, pa iu drejtuar organit kompetent. Pavarësisht nga e drejta dhe interesi i ligjshëm që mbrohet, veprimet e autorit, të çdo forme qofshin, drejtohen ndaj personit ose sendeve, në mënyrë arbitrare. Nëse këto veprime bëhen duke u shoqëruar me format e privimit të lirisë së personit, atëherë autori ka konsumuar edhe një vepër tjetër penale, atë të heqjes së paligjshme të lirisë, neni 110 i Kodit Penal.

Bazuar në arsyetimin e mësipërm, rezulton se të gjykuarit kanë konsumuar veprat penale të heqjes së paligjshme të lirisë dhe vetëgjyqësisë, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, parashikuar nga nenet 110/2 dhe 277 e 25 të Kodit Penal.

Gjykata, në analizë të rrethanave të faktit, personalitetit të secilit të gjykuar dhe rrezikshmërisë së tyre ashtu sikurse kanë pranuar gjykatat e tjera në arritjen e përfundimeve të tyre, çmon se të gjykuarit Edi Biba dhe Tonin Pjetri duhet të dënohen për veprën penale të heqjes së paligjshme të lirisë me nga 3 vjet burgim, ndërsa i gjykuari Paulin Prenga me 3 vjet e 6 muaj burgim, ndërsa për pjesët e tjera vendimi i gjykatës se apelit duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 141/2 të Kushtetutës, të neneve 14/c dhe 17/b të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 438 të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSËN:

Lënien në fuqi të vendimit nr.163, datë 11.3.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë, lidhur me deklarinimin fajtor të të gjykuarve për veprën penale të vetëgjyqësisë dhe për të gjykuarin Paulin Prenga edhe për mbajtje arme pa leje.

Ndryshimin e vendimit përsa i përket cilësimit juridik të veprës penale, duke i deklaruar të tre të gjykuarit fajtorë për veprën penale të heqjes së paligjshme të lirisë sipas nenit 110/2 të Kodit Penal.

Dënimin e të gjykuarve Edi Biba dhe Tonin Pjetri me tre vjet burgim dhe të gjykuarin Paulin Prenga me 3 vjet e gjashtë muaj burgim. Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimit, i gjykuari Paulin Prenga dënohet përfundimisht me 3 vjet e gjashtë muaj burgim.

Ky vendim për njehsimin e praktikës gjyqësore dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 25.3.2005

MENDIMI I PAKICËS

Në vendimin unifikues nr.1, datë 25.3.2005 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Pakica nuk është dakord me vendimin e shumicës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si përsa i përket zgjidhjes që u dha prej saj në këtë çështje (dispozitivit), ashtu edhe pjesës arsyetuese të tij, rrjedhojë e së cilës është kjo zgjidhje.

Nga aktet e dosjes rezulton se ditën e ngjarjes, gjatë kohës që i dëmtuari Besnik Lleshi ishte duke drekuar me dy shokë të tij në një lokal në fshatin Fierzë (Kurbin), tre të gjykuarit, duke qenë të armatosur me lloje të ndryshme armësh luftarake, (pistoletë, automatik dhe pushkë të gjatë), kanë shkuar atje, me automjetin e tyre dhe, pa bërë ndonjë bisedë të mëparshme me këtë të dëmtuar, duke i drejtuar armën, e detyruan që t’i shoqëronte në automjetin e tij që ndodhej i ndaluar në rrugë, para lokalit. Me çelësat që i morën të dëmtuarit, nën kërcënimin e armës, hapën derën e automjetit të këtij të fundit dhe, pasi, po me kërcënimin e armëve, e hipën në sediljen e përparme të pasagjerit, mbrapa së cilës, me armë të drejtuar mbrapa kokës së tij, u ul i gjykuari Pjetri, i gjykuari Biba nisi automjetin në drejtim të qytetit të Lezhës, kurse i gjykuari i tretë, Prenga, i ndiqte nga mbrapa me automjetin me të cilin ata kishin shkuar në vendin e fillimit të kësaj ngjarjeje.

Pa arritur ende në fshatin Pllan, të gjykuarit e urdhëruan të dëmtuarin, që t’u jepte 10 milionë lireta italiane, (sipas të dëmtuarit për t’ia dhënë një personi me emrin Altin Nikolli, të cilin ata e

quanin "Kapo", kurse, sipas gjykatave, për llogari të një borxhi). Ndërkohë, nën kërcënimin e armëve, i grabitën 500 mijë lireta që i kishte me vete.

Gjykatat, përfshirë edhe shumicën e Kolegjeve të Bashkuara, pranojnë se, duke qenë që policia, e lajmëruar nga shokët e të dëmtuarit, ishte vënë në ndjekje, për t'i shpëtuar kapjes, të gjykuarit lanë automjetet në një rrugë dytësore dhe për t'u shmangur, filluan të ngjiten në një rrugë malore fshati, ku, duke qenë vazhdimisht të ndjekur nga policia, u detyruan ta lënë të lirë të dëmtuarin dhe vetë u larguan me shpejtësi, për t'u fshehur, duke u rënë, madje, dhe njëra nga armët, në vendin e ngjarjes.

Duke e reduktuar ngjarjen vetëm në shpjegimet e të gjykuarve, sipas të cilave veprimet, si më sipër, i kishin kryer për të marrë nga i dëmtuari një sasi të hollash që, njërit prej tyre, ia kishte dërguar, nëpërmjet tij, vëllai nga Italia, shumica i cilësoi ato si vetëgjyqësi, heqje të paligjshme të lirisë dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake, vepra penale këto të parashikuara nga nenet 277, 110/II dhe 278/II të Kodit Penal. Prokuroria i kishte akuzuar ata për krimet e rrëmbimit të personit dhe të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuara nga neni 109 i Kodit Penal, në lidhje me nenin 25 të tij dhe neni 278/II i këtij Kodi, qëndrim që u mbajt edhe nga përfaqësuesi i Prokurorisë së Përgjithshme, gjatë shqyrtimit të çështjes, si në Kolegjin Penal, ashtu edhe në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Pakica është e mendimit se kërkesa e prokurorit është e drejtë dhe duhej të ishte pranuar.

Në këtë përfundim pakica, ndryshe nga mënyra e copëzuar që përdor shumica për të bërë interpretimin e dispozitave të neneve 109, 110/II dhe 277 të Kodit Penal, në të cilat janë parashikuar, përkatësisht figurat e veprave penale të rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit, të heqjes së paligjshme të lirisë dhe vetëgjyqësisë arriti, duke ballafaquar, përmbajtjen e secilës prej tyre, me njëra-tjetrën (interpretimi sistematik).

Pakica niset, së pari, nga përmbajtja e dispozitës së nenit 109 të Kodit Penal, në të cilën parashikohet figura e krimit të rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit, dispozitë në të cilën, në mënyrë qartësisht të shprehur, përshkruhen format dhe mënyrat nëpërmjet të cilave kryhet kjo veprë penale, nga ana objektive.

Ligjvënësi në këtë dispozitë ka përcaktuar dy format nëpërmjet të cilave kryhet kjo figurë krimi, nga ana objektive, që janë: a) rrëmbimi i personit dhe b) mbajtja peng e tij. Mjafton ekzistenca e njëres prej tyre për të pasur të plotësuar anën objektive të saj. Dhe, për të dalluar figurën e krimit të rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit (neni 109 i Kodit Penal) nga figura e veprave penale të heqjes së paligjshme të lirisë dhe vetëgjyqësisë (nenet 110 dhe 277 të Kodit Penal), i ka kushtëzuar, si rrëmbimin, ashtu edhe mbajtjen peng, me anën subjektive të autorit të tyre (rrëmbimit apo mbajtjes peng i personit). Kushtëzimi konsiston në faktin që, jo çdo lloj rrëmbimi apo mbajtje peng i personit (pavarësisht nga mënyra dhe mjetet e përdorura), do të përbëjë rrëmbim apo mbajtje peng, si element të anës objektive të figurës së krimit, të parashikuar nga neni 109 i Kodit Penal.

Sipas kësaj dispozite, (nenit 109 të Kodit Penal), këto veprime (rrëmbimi dhe mbajtja peng e personit) do të përbëjnë anën objektive të figurës së krimit që parashikohet prej saj, me kushtin dhe vetëm atëherë kur kryhen për të arritur një nga qëllimet e renditura shprehimisht në përmbajtjen e vetë kësaj dispozite. Pikërisht këto qëllime përbëjnë edhe qëllimin e posaçëm që është elementi karakteristik, i cili, përveç dashjes direkte përbën anën subjektive të figurës së krimit të parashikuar në nenin 109 të Kodit Penal. Ky është edhe elementi bazë që dallon këtë figurë krimi nga figura e veprës penale të heqjes së paligjshme të lirisë (neni 110 i Kodit Penal). Po të niseshim vetëm nga ana objektive, vështirë se do bëhej i mundur dallimi midis tyre, pasi si rrëmbimi, (në kuptimin e përgjithshëm të kësaj fjale), ashtu edhe mbajtja peng e personit, janë dy nga mënyrat që ndeshen më shpesh në praktikën e gjykatave, nëpërmjet të cilave, realizohet vepra penale e heqjes së paligjshme të lirisë. Kjo e fundit mund të kryhet nisur nga motive dhe për të arritur qëllime nga më të ndryshmet, përjashtuar qëllimet dhe motivet, të cilat ligjvënësi i ka përmendur, në mënyrë alternative, në përmbajtjen e dispozitës së nenit 109 të Kodit Penal.

Si qëllime të kësaj natyre, ligjvënësi ka renditur:

- a) për të fituar pasuri ose çdo lloj përfitimi tjetër;
- b) për të përgatitur krijimin e kushteve lehtësuese për kryerjen e një krimi;
- c) për të ndihmuar fshehjen ose largimin e autorëve ose bashkëpunëtorëve në kryerjen e një krimi;
- ç) për t'u shmangur dënimit;
- d) për të detyruar realizimin e kërkesave a kushteve të caktuara;

dh) për qëllime politike dhe;

e) për çdo qëllim tjetër.

Këtej arrihet lehtë në përfundimin se edhe ushtrimi i një të drejte prej personit që i përket ose që kujton se i përket dhe që nuk i njihet nga tjetri, pa iu drejtuar organit kompetent shtetëror, (që përbën thelbin e figurës së kundërvajtjes penale të vetëgjyqësisë, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal), kur nuk shoqërohet me veprime që përbëjnë rrëmbim apo mbajtje peng të personit, përbën figurën e kundërvajtjes penale të vetëgjyqësisë. Kurse në rastet kur ushtrimi i kësaj të drejte (që i përket ose që kujton se i përket) shoqërohet me veprime të subjektit, të cilat përbëjnë ose rrëmbim, ose mbajtje peng të personit nga i cili kërkohej realizimi i një të drejte të tillë, vepra cilësohet jo më si vetëgjyqësi (neni 277 i Kodit Penal), por si rrëmbim apo mbajtje peng e personit. Ushtrimi i një të drejte prej personit që i përket ose që kujton se i përket dhe që nuk njihet nga tjetri, pa iu drejtuar organit kompetent shtetëror, në këtë rast, përbën një nga format e konkretizimit të qëllimeve - element i anës subjektive të figurës së krimit të parashikuar nga neni 109 i Kodit Penal. Me këtë duhet kuptuar që vetë figura e kundërvajtjes penale të vetëgjyqësisë, në këtë rast, përbën anën subjektive të figurës së krimit të rrëmbimit apo mbajtjes peng të personit-qëllimin e saj. Për rrjedhojë, e para, në këtë rast, thithet nga figura e krimit të rrëmbimit apo mbajtjes peng të personit.

Pakica është e mendimit që, sa u vunë në dukje në këto dy paragrafë, duhej të përbënin edhe një nga përcaktimet unifikuese (sentencat) e këtij vendimi, përcaktime që, për hir të së vërtetës, duhet thënë që, në mos i mungojnë, nuk mund të dallohen qartë midis rreshtave të vendimit të shumicës së Kolegjeve të Bashkuara.

Përcaktimin e dytë unifikues, sipas pakicës, duhej ta përbënte përfundimi, sipas të cilit edhe pse rrëmbimi apo mbajtja peng e personit, në rrethana të zakonshme, janë nga ato veprime që, zakonisht, përbëjnë anën objektive të figurës së veprës penale të heqjes së paligjshme të lirisë, parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal, kur kryhen për realizimin e ndonjërit prej qëllimeve që përmenden në dispozitën e nenit 109 të këtij Kodi, duhet të cilësohen si rrëmbim apo mbajtje peng të personit, figurë krimi kjo që parashikohet, pikërisht nga kjo dispozitë.

Kështu që, ndërsa në rastin e parë, veprimet e vetëgjyqësisë përbënin anën subjektive të figurës së krimit të rrëmbimit apo mbajtjes peng të të dëmtuarit Besnik Lleshi, në rastin e dytë, veprimet që konsistonin në heqjen e paligjshme të lirisë së tij, përbëjnë anën objektive të kësaj figure krimi (nenit 109 të Kodit Penal).

Pakica është e mendimit se nuk mund të ketë konkurrim as midis figurës së veprës penale të heqjes së paligjshme të lirisë (kur veprimet drejtohen ndaj të njëjtëve persona) dhe figurës së krimit të rrëmbimit apo mbajtjes peng; as midis kësaj të fundit dhe figurës së kundërvajtjes penale të vetëgjyqësisë (kur si në rrëmbimin apo mbajtjen peng, ashtu edhe nga vetëgjyqësia dëmtohen të njëjtët persona). Për rrjedhojë, duke qenë se në të drejtën penale vepron parimi që, në këto raste, vepra më e lehtë thithet nga ajo më e rënda, Kolegjet e Bashkuara duhej të prishnin vendimet e dy gjykatave dhe t'i deklaronin fajtorë të gjykuarit për krimin e parashikuar nga neni 109 i Kodit Penal, në lidhje me nenin 25 të tij.

Përsa i përket krimit të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të tre të gjykuarit duhej të ishin deklaruar fajtorë.

Gjyqtarë: Spiro Spiro, Perikli Zaharia, Valentina Kondili, Vladimir Bineri, Besnik Imeraj, Irma Bala

VENDIM

Nr.349, datë 10.6.2005

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISION VENDOR PRIVAT "TV BERATI"

SUBJEKTIT: Z. NAUN SHTREPI

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", rregullores "Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", të miratuar me vendimin nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në muajin mars, si dhe të vendimit të KKRT-së nr.337, datë 20.5.2005, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T'i japë subjektit fizik z.Naun Shtrepi, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve analogjike tokësore, për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal rrethin e Beratit.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Halil Lalaj

VENDIM

Nr.350, datë 10.6.2005

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK
“BOOM-BOOM”**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, të kërkesës së subjektit të interesuar, si dhe të vendimit nr.339, datë 20.5.2005, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.036/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë subjektin “Boom Boom Radio TV” sh.p.k. për radion “Boom-Boom”.

2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.

3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 15.5.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Halil Lalaj

VENDIM

Nr.352, datë 10.6.2005

**MBI ZGJERIMIN E ZONËS SË LICENCIMIT TË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR PRIVAT
“NEWS 24”**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, vendimit të KKRT-së nr.87, datë 29.3.2002, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në muajin mars, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit “Edisud Radio-TV” sh.p.k. për

televizionin vendor privat "News 24", sipas licencës nr.056/TVL, në prefekturat Fier dhe Vlorë.

2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.

3. Ngarkohet departamenti teknik, departamenti ekonomik dhe departamenti juridik dhe i licencave për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Halil Lalaj

SHPLLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të objektit "Rikonstruksionin e lagjes "Granicë" në qytetin e Gjirokastrës".

Subjekti kërkues i këtij objekti është bashkia Gjirokastrë. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i shpronësimit pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, për secilin person sipas listës emërore të mëposhtme.

PËR TOKËN TRUALL

Nr.	Emri, mbiemri	Sip/toke truall	Çmimi i tokës/m ²	Vlera në total (lekë)
1.	Pandeli (Pano) Kalanderi	26 m ²	750	19 500

PËR GARAZHIN

Nr.	Emri, mbiemri	Emërtimi garazh	Vlera në lekë
1.	Pandeli (Pano) Kalanderi	30 m ²	534 599

Gjithsej vlera totale e shpronësimit: 554 099 lekë.

Vlera e shpenzimeve procedurale do të përballohet nga subjekti kërkues, bashkia Gjirokastrë.

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me vendim nr.1231, datë 15.6.2005 vendosi të caktojë shtetasen Pranvera Zaçe si kujdestare të fëmijëve të mitur Sherif Zaçe dhe Marius Zaçe.

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
- Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdo lloj informacioni, shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJI PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

DOLI NGA SHTYPI:

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

Doli nga shtypi më 8.7.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë